

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7708 E martë 13 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Pavarësisht se u mvesh me petkun hijerëndë të një debati konstitucional, ajo që përplasi Ramën me Metën po rezultojnë të ketë qenë një akt banal i rilindjes ...
Vijon në faqen 20

Nga ANDI BUSHATI

**Sandër Lleshi
si një PPP banale**



Opinion **i** Ditës

Nga JULIAN ZYLA

Imagjinoni një skulpturë gjigante në hyrje të Parisit me flamurin kombëtar. Asnjë ide tjetër artistike përveç flamurit të kthyer në skulpturë. A do ta ...
Vijon në faqen 21

Kur Basha e pëlqen, pse nuk e bën shqiponjën tatuazh?



Unaza e Re/ "U shkel ligji i prokurimeve"

Banorët në protestë për shtëpitë, firma nën sekuestro fitoi tenderin 18 mln euro

Opozita akuzon: Skemë mafioze 40 milionë euro, fituesi u paracaktua. Bashkia: Japim bonus qiraje

VALENTINA MADANI

Partia Demokratike akuzoi dje kryeministrin dhe kryebashkiakun e Tiranës se kanë vënë në jetë një skemë korruptive me vlerë 40 milionë euro për më pak se 3 kilometra tek Unaza e Re. Kjo sipas zëdhënës Ina Zhupa ...
Në faqet 4-5

LISTA ME 5700 EMRA, DOKUMENTET QE MUNGOJNE NE DOSJEN E SECILIT

TE PERNDJEKURIT, KUSH E PERFITON DEMSHPERBLIMIN

Pjesa e tretë/ Ministria e Financave publikon trashëgimtarët që do të ndajnë fondin financiar. 3 muaj afat për plotësimin e dokumentacionit



(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë

Në faqet 14-17

TIRANE

Bonusi i strehimit, emrat e fituesve që do miratohen në këshillin bashkiak

Në faqen 8

MAQEDONI

Abuzimi me blerjen e makinës 600 mijë euro, urdhërarrest për Nikolla Gruevskin

Në faqen 11

LISTA E PERFITUESVE

Familjet që u prekën nga dëmet natyrore marrin ndihmë financiare

Në faqen 9

ROMANO MONTRONI

Miti i librarëve italianë në Tiranë: Lexohet shumë aty ku punohet me fëmijët

Në faqet 18-19

BUXHETI 2019



Rama: Sa do rriten rrogat e ushtarakëve. Ahmetaj: Pagat mbi 10 mijë lekë të taksohen

Në faqen 10

Presidenti, 14 pyetje Ministrisë së Mbrojtjes: Nuk e dekretova, ushtarak aktiv

Meta: Pse e refuzova gjeneralin. Rama: Hiqja gradën

Sandër Lleshi, presidentit: Pranoj vendimin e Nishanit, heq dorë nga ushtria

VALENTINA MADANI

Presidenti i Republikës, Ilir Meta zbardhi dje arsyen e refuzimit të parë për dekretimin e Sandër Lleshit në postin e ministrit të Brendshëm herën e parë. Z.Meta e konsideron emërimin e Lleshit si një problema-



tikë themelore kushtetuese. Kjo sepse sipas tij, ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore dhe as të marrin pjesë në parti apo veprimtari politike, ndërkohë që një ushtarak i shërbimit aktiv nuk mund të ...

Në faqet 2-3

MINISTRI DEKRETI

Valentina Madani

Letra për Xhaçkën, presidenti 14 pyetje jo sekrete për zëvendësministrin

Refuzimi, Meta: Një gjeneral nuk mund të jetë ministër i Brendshëm

"Kandidatura e Lleshajt, problematikë kushtetuese"



Kryeministri Edi Rama dhe zv.ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj

Presidenti i Republikës Ilir Meta zbardhi dje arsyen e refuzimit të parë për dekretimin e Sandër Lleshit në postin e ministrit të Brendshëm herën e parë. Z.Meta e konsideron emërimin e Lleshit si një problematikë themelore kushtetuese. Kjo sepse sipas tij, ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore dhe as të marrin pjesë në parti apo veprimtari politike, ndërkohë që një ushtarak i shërbimit aktiv nuk mund të kandidojë dhe as të zgjidhet ministër apo deputet pa hequr dorë më parë nga detyra. Për këtë arsye, presidenti i dërgoi një letër me 14 pyetje Ministrisë së Mbrojtjes ku në thelb është i shqetësuar vetëm për një fakt: A është apo jo Gjeneral Sandër Lleshi ende ushtarak aktiv, gjë e cila, sipas nenit 69 të Kushtetutës, e pengon për t'u zgjedhur deputet si një kritere që duhet të plotësojë për të qenë ministër? Përmes kërkesës që mban datën 9 nëntor, Presidenti Ilir Meta kërkon përgjigje shteruese nëse procesi gjyqësor i kandidatit për ministër ka përfunduar dhe çfarë procedurash ka ndjekur ministria e Mbrojtjes për të zbatuar vendimin e gjykatës për të rikthyer ose jo Sandër Lleshin në pozicionin e mëparshëm si zv./shf i Shtabit të Forcave të Armatosura dhe për ta shpërblyer në bazë të vendimit të gjykatës. "Duke qenë se kandidatura e Sandër Lleshit vjen nga një karrierë e gjatë ushtarake në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku ministri si funksion kushtetues është autoritet civil në zbatim të neneve 69, 103, 167/1 të Kushtetutës emërimi i tij në detyrën e ministrit të Brendshëm paraqet një problematikë themelore kushtetuese. Kjo sepse ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore dhe as të marrin pjesë në parti apo veprimtari politike, ndërkohë që një ushtarak i shërbimit aktiv nuk mund të kandidojë dhe as të zgjidhet ministër apo deputet pa hequr dorë më parë nga detyra", thuhet në letërën e Presidentit. Kreu i shtetit sqaron në këtë kërkesë, se kryeministri ishte vënë në dijeni edhe herën e parë mbi këtë ndalim kushtetues, e megjithatë kryeministri nuk ka dhënë asnjë shpjegim as shkresën e ridërguar për dekretim të zotit Lleshi, dhe që mban nr. 5211 datë 9.11.2018. "Megjithatë kryeministri është vënë në dijeni mbi këtë ndalim kushtetues sërish edhe në këtë propozim të ri, nuk është dhënë



Presidenti Ilir Meta

NDRYSHIMI

Në pyetjet e Presidentit Meta nuk mungojnë dhe detajet ku i kërkon kryeministrit nëse Sandër Lleshi ka ndërruar apo jo mbiemrin duke qenë se në vendimet gjyqësore mbiemri i tij figuron Lleshi, ndërsa në shkresën e kryeministrit figuron mbiemri Lleshaj.

ARSYET

Dokumenti rendit 14 pyetje, ku në 13 prej tyre kërkohet informacion shterues, siç cilësohet nga Presidencia, lidhur me statusin e Sandër Lleshajt si dhe të gjitha procedurat që Ministria e Mbrojtjes, ka ndjekur gjatë procesit gjyqësor. Në letër, Meta ka përfshirë dhe kreun e Kuvendit Gramoz Ruçi.

SHKURTE

Meta takon Presidentët e Kroacisë e Malit të Zi: Tri vende mike

Presidenti Ilir Meta zgjodhi dje transportin me tren për të udhëtuar për në Marsjë. Kreu i shtetit ndodhet për një vizitë të Francës, ku zhvilloi një takim me homologun francez, Emmanuel Macron. "Rrugës për Marsjë, së bashku me Ambasadorin tonë në Paris, Dritan Tola, për të marrë pjesë në Konferencën "Mediterranean of the Future", shkruan Meta. Presidenti i Republikës Ilir Meta pati një takim edhe me homologët e tij të Kroacisë dhe Malit të Zi, ku ka gjetur rastin të publikojë dhe një foto nga ky moment. Tre vende mike, me vizion të përbashkët për të ardhmen, shprehet Kreu i Shtetit duke falënderuar Kitarovic dhe Dukanovic. "Si gjithmonë një takim i përzemërt: Tre vende shumë mike, marrëdhënie të shkëlqyera, me vizion të përbashkët për të ardhmen, të vendosura në qëllimet e tyre euroatlantike dhe rajonale. Faleminderit Presidente Kolinda Grabar Kitarovic dhe President Milo Zukanovi!", shprehet Presidenti Meta.

Ambasadori i BE: Duhet Ministri e Brendshme tërësisht funksionale

Ambasadori i BE-së në vendin tonë, Luigi Soreca Apelolet sërish dje për një Ministri të Brendshme funksionale, duke iu referuar ngërçit Presidencia-Quveri për Sandër Lleshin. Në një intervistë për rrjetin "EëB", Soreca tha se lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është një nga detyrat kyçe të Shqipërisë për hapjen e negociatave me BE-në. Ambasadori i BE përmendi se gjatë javëve të fundit, Policia e Shtetit dhe Ministria e Brendshme kanë realizuar disa operacione kundër bandave kriminale. Por që kjo luftë të vazhdojë, tha Soreca, duhet një Ministri e Brendshme tërësisht funksionale. "Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është një përparësi kryesore për Shqipërinë në rrugën e saj drejt BE. Në javët dhe muajt e fundit, ministri i Brendshëm dhe Policia e Shtetit kanë realizuar disa goditje të rëndësishme kundër krimit të organizuar. Ne e mirëpresim këtë, kjo është ajo që do BE dhe vendet anëtare dhe kjo duhet të vazhdojë. Prandaj një Ministri e Brendshme tërësisht funksionale që të vazhdojë të luftojë krimin e organizuar, është thelbësore që Shqipëria të vazhdojë rrugën drejt BE-së", tha z.Soreca.

PYETJET E PARASHTRUARA NGA PRESIDENTI PËR FIGURËN E SANDËR LLESHIT

1. Çfarë vepimesh procedurale dhe materiale janë kryer nga Ministria e Mbrojtjes apo Shtabi i Përgjithshëm për ekzekutimin e Vendimit të formës së prerë nr. 5137, datë 07.12.2017 të Gjykatës së Apelit Administrativ, vendim ky që ka trajtuar pretendimet e z. Sandër Lleshi.
2. A ka ushtuar Ministria e Mbrojtjes të drejtën e kundërshimit, duke ushtuar rekurs në Gjykatën e Lartë kundër Vendimit nr. 5137, datë 07.12.2017 të Gjykatës së Apelit Administrativ dhe nëse po, cilat janë arsyet që Ministria e Mbrojtjes ka kundërshtuar këtë vendim gjyqësor të formës së prerë?
3. A jeni në dijeni nëse z. Sandër Lleshaj ka ushtuar të drejtën e kundërshimit duke paraqitur Kundër Rekurs, për të kundërshtuar Rekursin e paraqitur nga Ministria e Mbrojtjes në Gjykatën e Lartë dhe nëse po, cilat janë arsyet dhe pretendimet të parashtruara në këtë kundërrekurs të z. Sandër Lleshi që ka kundërshtuar rekursin e Ministrisë së Mbrojtjes?
4. A ka kryer Ministria e Mbrojtjes, apo Shtabi i Përgjithshëm i FA, veprim për ekzekutimin e këtij vendimi të Gjykatës së Apelit Administrativ, për sa i takon trajtimin financiar sipas dispozitivit të vendimit, ku gjykata urdhëron: "Detyrimin e palës së paditur Ministria e Mbrojtjes t'i paguajë paditësi Sandër Lleshi pagën nga data 29.05.2013, deri në datën e sistemitit të paditësit në detyrën e Zv./Shf-it të Shtabit të Përgjithshëm të FA, apo në një detyrë tjetër në përputhje me gradën që mban. Cili është niveli ekzekutimi të këtij vendimi gjyqësor deri në ditët e sotme?"
5. A ka qenë në dijeni Ministria e Mbrojtjes gjatë shqyrtimit gjyqësor se z. Sandër Lleshaj, ndërkohë që zhvilloheshin proceset gjyqësore, ishte i emëruar si Këshilltar i Kryeministrit?
6. A është ekzekutuar nga Ministria e Mbrojtjes vendimi i Gjykatës për sa i takon shlyerjes së shpenzimeve gjyqësore?
7. A ka parashtruar z. Sandër Lleshaj, ndonjë kërkesë personale apo nëpërmjet shërbimit Përmbarimor për vënien në ekzekutim të vendimit të Gjykatës dhe nëse po, lutemi përcjelljen e një kopje të kësaj kërkesë së bashku me dokumentacionin e plotë.
8. A ka parashtruar z. Sandër Lleshaj, ndonjë kërkesë në lidhje me trajtimin e tij financiar në zbatim të vendimit të

9. Si ka vlerësuar dhe si parashikon Ministria e Mbrojtjes ekzekutimin e vendimit gjyqësor me të cilin Gjykata e Apelit Administrativ, urdhëron: "Kthimin e paditësit Sandër Lleshi në detyrën e Zv./Shf-it të Shtabit të Përgjithshëm të FA, apo në një detyrë tjetër në përputhje me gradën që mban."
10. A ka patur ndonjë komunikim apo praktikë administrative shkresore midis Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm me institucionin e Kryeministrit në funksion të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ nr. 5137, datë 07.12.2017, për sa i takon rikthimin në një detyrë tjetër në përputhje me gradën që mban, për të njëjshuar funksionin që z. Sandër Lleshaj mbante si Këshilltar i Kryeministrit për Sigurinë Kombëtare që prej vitit 2013 e në vijim në zbatim të vendimit të gjykatës?
11. Nëse po, cili është qëndrimi që është mbajtur nga institucionet respektive dhe vënien në dispozicion të akteve respektive.
12. Me çfarë akti z. Sandër Lleshaj, ka kaluar në lirim, apo në rezervë në Forcat të Armatosura, pas daljes së vendimit nr. 5137, datë 07.12.2017 të Gjykatës së Apelit Administrativ dhe përpara paraqitjes së propozimit të Kryeministrit, për emërimin e tij në detyrën e ministrit të Brendshëm?
13. Nëse e dispononi, lutemi vënien në dispozicion të këtij akti.
14. Cili është vlerësimi i ministrisë së Mbrojtjes, për zbatimin në tërësi të vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ nr. 5137, datë 07.12.2017 tashmë pas emërimit të z. Lleshi si Zëvendësministër i Brendshëm, apo në rast të emërimit të tij si ministër i Brendshëm?
15. Në kërkesën e Kryeministrit propozohet që z. Sandër Lleshaj të emërohet ministër i Brendshëm. Ndërkohë konsultohet se në vendimet gjyqësore mbi këtë ushtarak, të dhënat personale të tij paraqiten me mbiemër Lleshi.

asnjë shpjegim, informacion si, dhe nuk është mbajtur asnjë qëndrim mbi këtë çështje dhe për pasojë të tjera që mund të lidhen me të. Për më tepër që në njoftimin fillestar të kryeministrit në rrjetet sociale të kryeministrit të datës 27 tetor 2018, por edhe në dal-

jet të tij publike Sandër Lleshi propozohet për emërimin si ministër i Brendshëm duke e trajtuar atë me gradën "Gjeneral", citohet letra e z. Meta drejtuar ministres Xhaçka. Presidencia shton se shkresa e dytë e kryeministrit është shoqëruar me një relacion

shpjegues, që janë dy fletë të panëshkruara: "Në këto kushte Presidenti i Republikës në zbatim të nenit 92/h vlerëson të domosdoshme paraqitjen e një informacioni shterues mbi pyetjet e parashtruara si dhe të dhëna me shkrim".



Ndreu: Njeriu vdes me gradën, çdekretimi tekë e Metës

Pjesë e debatit nëse Sandër Lleshaj duhet të kërkojë lirimin nga gjendja e ushtarakut aktiv ose jo, është bërë edhe deputeti i Partisë Socialiste dhe anëtar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare, Pjerin Ndreu. Ndryshe nga sa ka propozuar kryeministri, por edhe ka pretenduar presidenti në shkresën e tij, Ndreu shprehet se grada fitohet, ndërsa shtoi se askush nuk ka të drejtë që të cenojë atë. "Grada është personale dhe fitohet. Njeriu vdes me gradën që ka. Askush nuk ka të drejtë të cenojë gradën që dikush e ka marrë me meritë. Nëse ushtron funksionin për shkak të gradës, atëherë jemi në kushtet e ndalimit sipas Kushtetutës. Por Gjeneral Lleshaj nuk ushtron asnjë funksion që në vitin 2013. Kërkesa për çdekretim grade mund të jetë një tekë që i duhet plotësuar presidentit, por kurrsesi arsye për t'i hapur rrugë emërimit në detyrën e ministrit! Gradën gjenerali e ka fituar në bazë të meritave dhe s'ka të drejtë askush t'ia heqë e aq me pak të kërkojë vetë Lleshaj t'i hiqet", shkruan Ndreu.



Çështja "Lleshaj", Vasili: Rama, propozim antiligj

Kreu i grupit parlamentar i LSI, Petrit Vasili, akuzoi dje kryeministrin Rama se gënjeu për Sandër Lleshajn. Duke u ndalur tek shkresa që kryeministri i drejtoi Metës për dekretimin e Lleshajt, Vasili theksoi se Rama pranoi që ka bërë propozim antiligj. Sipas Vasilit, Rama s'la gënjeshtër pa thënë për të emëruar çinovnikun e tij ministër të Brendshëm. Kryeministri antiligj bie poshtë, gënjeu sheshit për Lleshin(aj). "Çkryeministër gënjeshtar. S'la gënjeshtër pa thënë për të emëruar çinovnikun e tij ministër të Brendshëm. Tani i pranoni të gjitha. Pranoni që ka bërë propozim ministri antiligj. Antiligji do të vendosë ligjin në Ministrinë e Brendshme? Antiligji do luftojë bandat e kimit të organizuar dhe trafiket? Antiligji do ndezë radarët që i fiku për 5 vjet që të kalonte një det me drogë? Antiligji do luftojë paranë e pisët që ngre kulla në mes të Tiranës? Antiligji që ulët në qeveri do luftojë vetveten? Kryeministri është ai përfaqësuesi i antiligjit, qytetarët janë në rrezik", shprehet z. Vasili.



Kreu i qeverisë shprehet i keqardhur se kriza mund të ishte shmangur që më parë

Rama: Krisja mund të evitohet, Lleshaj jo ushtarak aktiv

"Ju keni shkresën për ta çdekretuar si gjeneral"

Kur mbeten edhe pak ditë nga afati që ka presidenti për t'u shprehur edhe një herë mbi kandidaturën e Sandër Lleshajt, dy institucionet kryesore në këtë debat, Presidenca dhe Kryeministria kanë hyrë në një komunikim zyrtar shkresor, por edhe virtual, i cili dje është bërë publik edhe për mediat. Në fakt, ishte kreu i shtetit, ai që publikoi i pari një kërkesë dërguar Ministrisë së Mbrojtjes për informacione të detajuara mbi Sandër Lleshajn dhe statusin e tij juridik në raport me forcat ushtarake. Në përgjigje të këtij veprimi, jo thjesht të letrës, por të bërit të saj publike nga Presidenca, edhe kryeministri Edi Rama iu përgjigj me të njëjten mënyrë, duke publikuar në rrjetet sociale përgjigjen që i kishte kthyer si ekzekutiv Metës, por edhe kërkesën e Lleshajt për çdekretim. Rama që në krye të kësaj letre i bën me dije presidentit se nisur pikërisht nga pyetjet e shtruara prej tij, e gjithë kriza e këtyre ditëve do kishte qenë e evitueshme. "Pasi u njoha me shkresën tuaj drejtuar ministres së Mbrojtjes, nuk jua fsheh dot se u ndjeva i keqardhur, për faktin që nëse ju do t'i kishit shtruar qysh në krye të herës, pyetjet që ajo shkresë përmban lidhur me statusin e gjeneral Sandër Lleshajt, me siguri s'do ta kishim përjetuar krisjen e herës së parë", në procesin e dekretimit të ministrit të Brendshëm", shkruan Rama në letrën e tij. Më tej, ai thekson se në rast se do ishte vepruar që në fillim në këtë mënyrë, presidenti do kishte krijuar bindjen e plotë, ndërsa sot vendi do kishte një ministër të Brendshëm. "E them këtë, sepse jo vetëm ju do të kishit marrë përgjigjen shteruese që jep, besoj unë, shkresa e ministres për ju, por përtej çdo interpretimi të mundshëm pengues për dekretimin si ministër të statusit të gjeneral Lleshajt, pa diskutim do të kishim gjetur në rast interpretimesh të ndryshme, zgjidhjen e thjeshtë që po ju prezantoj sot", shkruan më tej Rama. Ndërsa e informon Presidentin me aktin e Lleshajt për ta çdekretuar, ai i kujton kreut të shtetit se praktika ligjore, por edhe ajo e vendosur tashmë në vend, është që Lleshaj duhet ta bënte këtë akt vetëm



Kryeministri Edi Rama

PËRGJIGJA
"Jo vetëm ju do të kishit marrë përgjigjen shteruese që jep, besoj unë, shkresa e ministres për ju, por përtej çdo interpretimi të mundshëm pengues për dekretimin si ministër të statusit të gjeneral Lleshajt, pa diskutim do të kishim gjetur në rast interpretimesh të ndryshme, zgjidhjen e thjeshtë që po ju prezantoj sot".

"Nuk jam më ushtarak aktiv, por i liruar"

Lleshi ofron zgjidhje për ngërçin, largohet nga ushtria

Ashtu siç edhe pritej, palët që janë përfshirë në ngërçin institucional për emërimin e ministrit të ri të Brendshëm, kanë dhënë dje shenja shtensionimi mes tyre. Dhe për këtë ka menduar vetë i zgjedhuri i kryeministrit Edi Rama për të qenë ministër i Brendshëm, gjeneral Sandër Lleshaj, i cili nëpërmjet një letre drejtuar Presidentit të Republikës kërkon largimin nga gjendja e ushtarakut aktiv, duke hequr dorë përfundimisht nga drejta për të riveshur uniformën ushtarake. Letra është publikuar dje nga kryeministri, Edi Rama dhe ajo përmban një shpjegim të Lleshajt mbi gjithë procesin gjyqësor dhe statusin e tij aktual në raport me forcat ushtarake. "Me pranimin e këtij propozimi, i cili lidhet në mënyrë pandashme me mosushtrimin e funksionit të ushtarakut, unë kam vendosur edhe heqjen dorë nga karriera



anë të kësaj letre se, në cilësinë e gjyqituesit, me institucionin që ju drejtoni dhe me Ministrinë e Mbrojtjes, heq dorë plotësisht nga të gjitha të drejtat që burojnë nga vendimi i gjykatës", shprehet Lleshi në letrën e tij dërguar Metës. Më tej, ai shpreh bindjen se kjo kërkesë do të merret në konsideratë prej presidentit, duke bërë të ditur se nga ky moment nuk është më ushtarak aktiv. "Në interpretimin tim nuk ka pengesë ligjore për dekretimin tim nga ana juaj, por mirëpres

pasi të dekretohet si ministër. "Ju keni shkresën e zëvendësministrit Sandër Lleshaj për ta çdekretuar si gjeneral aktiv, në rast se ndryshe nga ne që mendojmë se ky nuk është rasti, ju mund të mendoni se statusi i tij

aktual është ai i gjeneralit aktiv. Ekspertët tanë mbrojnë gjithashtu bindjen se çdekretimi i tij si i tillë nga Presidenti i Republikës, do të duhej bërë pas miratimit nga Kuvendi të dekretit tuaj për të si ministër", bën të di-

çfarëdolloj akti administrativ nga ana juaj apo e çdo organi përgjegjës të parashikuar në ligj, që do të qartësonte dhe do të vendoste pa asnjë keqkuptim se nuk jam më ushtarak aktiv, por i liruar nga shërbimi aktiv ushtarak", shkruan Lleshaj, i cili thekson se e ndërmerr këtë hap për t'i dhënë zgjidhje "ngërçit kushtetues". Pavarësisht këtij hapi, ai shprehet se pavarësisht vendimit të gjykatës, ai nuk është ushtarak aktiv, por vetëm gjyqitues.

UNAZA E RE PROTESTAT



PROTESTA

"Shqiponjën e hoqe, ne nuk na heq dot", "Lali Eri ku je fshehur?", "Shtëpitë tona do t'i mbrojmë me duart tona", "Dy duar për një kokë" si dhe "S'kemi frikë nga presioni i qeverisë", lexohet në pankartat që mbanin në duar protestuesit, të cilën u shprehën se nuk do të pranoheshin shembjen e shtëpive të tyre deri sa të dëmshpërblehen 100%.



E VEJA E DIKTATORIT

Nga projekti i Unazës së Re preket dhe ish-godina e pularisë ku prej vitesh strehohet ish-bashkëshortja e diktatorit Enver Hoxha. Në këtë godinë janë strehuar disa familje, pjesë e nomenklaturës komuniste. Asnjë nga banorët përfshi edhe Nexhmie Hoxhën nuk kanë pranuar të marrin letrat për largimin nga shtëpia.



Protesta e banorëve të Unazës së Re, dje para bashkisë

Drejtoresha e Strehimit: Kredia e butë apo banesat sociale, mundësi

Ndërtimi i Unazës, banorët i japin ultimatum bashkisë

Ruseti: Bonus qiraje për familjet e prekura

Banorët e zonës së 'Unazës së Re' presin sot nga Bashkia e Tiranës përgjigje se çdo të bëhet për kompensimin e shtëpive që preken nga projekti i rrugës. Me thirrje në kor: "Poshtë diktatura, shtëpitë tona janë me gjak. Turp, turp...", protestuesit qëndruan për rreth 1 orë e 30 minuta para bashkisë në pritje të një takimi me kryebashkiakun Erion Veliaj. Por ndërkohë përgjigja erdhi nga Drejtoresha e Politikave Sociale në Bashkinë e Tiranës, Anisa Ruseti e cila e ftuar në rubrikën Opinion në News24, u shpreh se bashkia do ofrojë bonus qiraje për 1 vit për familjet që preken nga projekti i Unazës së Re. Ruseti u shpreh se është bërë një vlerësim social-ekonomik për familjet e prekura nga projekti dhe se po shihet mundësia se si mund të ndihmohen për një përuardhje afatgjatë këto familje. "Unaza e Re është një projekt madhor që prek disa familje dhe biznese. Nga vlerësimi paraprak, bëhet fjalë se Unaza është e ndarë në 5 lote. Ka disa objekte që janë të ndërtuara në mënyrë jo formale dhe me këtë pjesë po merret ALUIZNI. Kemi bërë një vlerësim social-ekonomik për familjet e prekura. U kemi treguar se si do ndihmohen këto familje. Ne po diskutojmë për t'u ofruar bonus qiraje për 1 vit për këto familje. Gjatë kësaj kohe do shohim si mund të zgjidhim problemin e tyre për një periudhë afatgjatë. Mund të jenë programe të ndryshme si kredia e butë apo banesat sociale" tha



Drejtoresha e Politikave Sociale në Bashkinë e Tiranës, Anisa Ruseti

Ruseti duke shtuar se për bashkinë emergjente është akomodimi i familjeve që preken nga ky projekt. Bashkia do paguajë 100% qiranë për një vit me të drejtë ripërtëritje. Qytetarët janë njoftuar për projektin që preken. Qëllimi ynë është që të gjejmë një zgjidhje edhe për punësimin e tyre. Banorët do kenë kohën e duhur për të gjetur mundësinë e një strehimi. Dëmshpërblimi me vlerën e tregut që kërkojnë banorët ndiqet me VKM për dëmshpërblimet dhe nuk është kompetencë e bashkisë" përfundoi drejtoresha e strehimit. Për ndërtimin e Un-

azës së Re janë evidentuar rreth 317 objekte që do të prishen, 163 prej të cilëve janë në proces legalizimi dhe do të skualifikohen, 123 janë me vërtetime pronësie dhe pastaj për të tjerat nuk kanë asnjë lloj informacioni. Nga projekti i Unazës së Re preket dhe ish-godina e pularisë ku prej vitesh strehohet ish-bashkëshortja e diktatorit Enver Hoxha. Në këtë godinë janë strehuar disa familje pjesë e nomenklaturës komuniste. Asnjë nga banorët përfshi edhe Nexhmie Hoxhën nuk kanë pranuar të marrin letrat për largimin nga shtëpia.

317

OBJEKTE

Për ndërtimin e Unazës së Re janë evidentuar rreth 317 objekte që do të prishen, 163 prej të cilëve janë në proces legalizimi dhe do të skualifikohen, 123 janë me vërtetime pronësie dhe pastaj për të tjerat nuk kanë asnjë lloj informacioni.

PROJEKTI

"Unaza e Re është një projekt madhor që prek disa familje dhe biznese. Nga vlerësimi paraprak, bëhet fjalë se Unaza është e ndarë në 5 lote. Ka disa objekte që janë të ndërtuara në mënyrë jo formale dhe me këtë pjesë po merret ALUIZNI. Kemi bërë një vlerësim social-ekonomik për familjet e prekura".

FTESË PËR OFERTË

Islamic Relief Albania në kuader të Projektit të Dimrit, kërkon të blejë:

- **DRU ZJARRI** (faza e pare 400 m3, faza e II mund të porositen dhe 400 m3 ekstra)
 - Specifikime Teknikë
 - Lloji: Dru Zjarri Ahu
 - Njesia: M3
 - Dimensionet: Paleta që mban 2 m3 dru
 - Druri të jete i prerë gati për përdorim dhe i stivësuar ne paleta
 - Zonat: Korçë, Pogradec
- **BATANJE TEKE (160 copë)**
 - Specifikime:
 - Masa: Teke
 - Dimesionet: 160x220 cm
- **PRODUKTE USHQIMORE (100 Pako)**

Parashikohen të përgatiten rreth 100 pako ushqimosh, 1 pako ushqimesh do të përbëjë: (Oriz 3kg, Makarona 2.5kg, Sheqer 2kg, Miell 3kg, Vaj Luledielli 4 Liter, Reçel 360gr (2 vazo), Fasule 1kg) Per detaja ne lidhje me kerkesat per kete ftese ne tender, klikoni ne faqen zyrtare te Facebook: Islamic Relief Albania. Overta juaj duhet të jetë në një zarf të mbyllur dhe të vulosur dhe duhet dërguar në adresën: Adresa: Laprake, rruga e Durrësit, Blloku Gintash, pall E, kati i II, ap 8, Tirana ose mund ta dergoni ne posten elektronike: info@islamirelief.al

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është më datën 30.11.2018. Për çdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni në: info@islamirelief.al ose te kontaktoni ne: Tel.: +355 42413190, 0676007676

DOMINUS Njoftim per shitje me ankad

Shoqëria Përmbarimore "Dominus" Rruga "Samir Frashëri"p/ll "Titani", kalë tërre Tirane. cel 0692055122

Shitje me ankad e pasurise

Tokë Arë, Nr.Pasurise 104/16, ZK 3774, vol 3, faqe 141, e ndodhur në Vllë-Ballaj, Kavajë

Çmimi fillestar me të cilin fillon shija e pasurisë në ankad është 1.890.000 lekë (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë), ne pronesit te Lirim Jella

Hapja e ofertave do të bëhet ditë e martë, datë 20/11/2018, Ora 16:00, në selinë e shoqërisë përmbarimore "DOMINUS" SHPK në adresën:Rr.Sami Frashëri,Pallati Titan,Kati 3,Tiranë"



Rindërtimi i Unazës së Re, Zhupa: Të dëmshpërblehen banorët e prekur

Tenderi, PD: Qeveria, skemë mafioze 40 mln euro tek Unaza e Re

“Kompania nën sekuestro fitoi 18 milionë euro”

Valentina Madani

Partia Demokratike akuzoi dje kryeministrin dhe kryebashkiakun e Tiranës se kanë vënë në jetë një skemë korruptive me vlerë 40 milionë euro për më pak se 3 kilometra tek Unaza e Re. Kjo sipas zëdhënësës Ina Zhupa, është arsyeja pse heshtet para protestës së qytetarëve. Fituesi i tenderit, sipas PD-së, ka probleme ligjore. Zëdhënësja Zhupa denoncoi kryeministrin dhe kryetarin e Bashkisë së Tiranës se i kanë dhënë miliona euro një kompanie që ishte nën sekuestro dhe se projekti për zgjerimin e Unazës së Re është një afere e pastër korruptive në kurriz të banorëve që nuk do të marrin asnjë dëmshpërblim për shpëtitë që po u prishen. “Edi Rama dhe Erion Veliaj po heshtin, sepse ata kanë vënë në jetë një skemë korruptive me vlerë 40 milionë euro për më pak se 3 kilometra, duke ndërhyrë në rrugë nga Pallati me Shigjeta tek sheshi ‘Shqiponja’, të cilit tani i ka mbetur që Edi Rama t’i heqë edhe emrin”, deklaroi PD.

AKUZA

“Edi Rama dhe Erion Veliaj po heshtin, sepse ata kanë vënë në jetë një skemë korruptive me vlerë 40 milionë euro për më pak se 3 kilometra, duke ndërhyrë në rrugë nga Pallati me Shigjeta tek sheshi ‘Shqiponja’, të cilit tani i ka mbetur që Edi Rama t’i heqë edhe emrin”, deklaroi PD.

Skandali/ Investigimi i "Exit.al"

Zbulimi, kush janë kompanitë e panjohura që fituan 18 mln euro

Ndërsa dy kompanitë fituese të lotit 2 dhe 3 të Unazës së Re, janë kompani të njohura ndërtime, kompanitë 'Biba-X' dhe 'DH Albania' janë të panjohura. 'DH Albania' është kompani regjistruar në Shqipëri më 18 korrik 2018 si degë e një kompanie të huaj Dunëel Haberman, me përfaqësues ligjor 26 vjeçar in Avdijol Dobi. Kompania mëmë, Dunëel Haberman Ltd është regjistruar në një parajsë fiskale, në shtetin Delaëare të SHBA-ve dhe duket të jetë një kompani rafti-kompani pa aktivitet, e krijuar për t'u shitur në letër. Në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si përfaqësues ligjore e kompanisë mëmë është regjistruar Neshia Lynn Kumar, shtetase dhe banore e Ishujt Sejsheh. Kompania mëmë ka një faqe online e cila është krijuar më 2 korrik 2018, pak më shumë se dy javë para se kompania të regjistronte degën e saj në Shqipëri. Në faqe nuk ka asnjë informacion për personat drejtues të kompanisë dhe asnjë informacion për angazhimet e saj në të shkuarën. Sikurse u shprehëm më sipër, kompania duket të jetë një kompani rafti, pa asnjë aktivitet, e cila shërben si kompani guackë për të të fshehur pronarët e vërtetë të saj. Kompania tjetër e konsorciumit, 'Biba-X', është regjistruar në Kavajë në vitin 2002, me objekt prodhim të materialeve të ndërtimit, kryesisht prodhim dhe tregtim inertesh. Më 15 tetor 2018, ortaku i vetëm, Barush Biba ka ndryshuar objektin e kompanisë duke shtuar objektin "ndërtim rrugësh, ndërtime civile, rikonstrukcion godinash fasadash". Edhe në praktikë, aktiviteti kryesor i kompanisë ka qenë shfrytëzimi i inerteve në shtratit e lumit Shkumbin në Elbasan. Vetëm pas vitit 2014, kompania ka përfutur 3 kontrata publike për ndërtimin e rrugëve dytësore në Bashkinë Tiranë, Kavajë dhe Pogradec. Nga viti 2013 deri më tetor të 2018 kompania ka qenë vazhdimisht nën sekuestro për fatura të pashlyera ndaj kontraktorëve të ndryshëm, të cilët kanë marrë urdhëra gjyqësore kundër kompanisë deri në shlyerjen e detyrimeve. Biba-X ka qenë nën sekuestro edhe gjatë periudhës kur ka konkuruar në tenderin e rrugës së re, duke konkuruar kështu në shkelje të ligjit.



Skema e dyshimtë e tenderimit të rrugës tek Unaza e Re, sipas opozitës

Reagimi, ARRSH: Prokurimi sipas ligjit, nuk bëjmë asnjë shkelje

Autoriteti Rrugor Shqiptar hodhi poshtë dje të gjitha akuzat e opozitës, ndërsa sqaroi procedurat për tenderin. ARRSH deklaroi se procedura e prokurimit është zbatuar sipas ligjit, ndërsa kompania nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. "Procedura e prokurimit është zhvilluar në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 'Për Prokurimin Publik' i ndryshuar, VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 'Për miratimin e rregullave të prokurimit publik' e ndryshuar. Referuar dokumenteve të tenderit, janë krijuar të gjitha hapësirat e nevojshme për shoqëritë vendëse ose të huaja në paraqitjen e ofertave dhe plotësimin e kriterëve të dhëna në dokumentet e tenderit. Janë përcaktuar qartë rregullat kur ofertuesit paraqiten si bashkim i përkohshëm i opera-



REAGIMI

"Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar dokumentacionin e dhënë duke kualifikuar vetëm bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomik 'Biba x shpk' & 'DH Albania shpk - degë e shoqërisë së huaj', pasi ka konstatuar që dokumentet janë në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit", thuhet në reagimin e ARRSH.

tove ekonomik. Më datë 17.10.2018 ora 10.00, është bërë hapja publike e procedurës së prokurimit, nëpërmjet sistemeve elektronike. Është konstatuar që kanë marrë pjesë 1.'Biba x shpk' & 'DH Albania shpk - degë e shoqërisë së huaj' me ofertën ekonomike 2.246.450.000,09 lekë, pa TVSH. 2.'Vëllëzërit Hysa shpk' nuk kanë paraqitur dokumentacion dhe as ofertë. Komisioni

i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar dokumentacionin e dhënë duke kualifikuar vetëm bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomik 'Biba x shpk' & 'DH Albania shpk - degë e shoqërisë së huaj', pasi ka konstatuar që dokumentet janë në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit", thuhet në reagimin e ARRSH.

Prokurimeve Publike", deklaroi zj.Zhupa. Sipas PD-së: "Dokumentet që tregojnë se kompania 'Biba X' ka qenë nën sekuestro në momentin e pjesëmarrjes në tender dhe në momentin e shpalljes fitues. Gjithçka ka ndodhur në shkelje të ligjit të prokurimeve publike që, për të rritur sigurinë e realizimit në kohë të veprës, kërkon që kompanitë të kenë siguri financiare,

të mos jenë në proces falimentimi apo nën sekuestro. 'Biba X' ka urdhër sekuestro nga përmbartuesi më datë 3 korrik. Tenderi është hapur në 10 shtator dhe fituesi është shpallur 5 javë më vonë. Gjatë kësaj kohe, përfituesi i 18 milionë eurove, bashkë me një kompani fantazmë, ka qenë nën sekuestro, që i është hequr pas shpalljes fitues të tenderit, më 24 tetor".

SHKODËR - Një intrigë çoi në ekzekutimin e ish-policit Boran Bërçana dhe bashkëjetueses e tij, Silvana Ndoci. Hetimet kanë zbuluar përhapjen e një thashethemi ka pasur për qëllim futjen në konflikt të bandave rivale në Shkodër. Për këtë arsye u përhap fjala sikur Boran Bërçana ishte shprehur, "unë e shtypa butonin e bombës ndaj Lul Kullës". Behet fjalë për shpërthi-



Boran Bërçana dhe Silvana Ndoci

Shkodër, ja intriga që çoi në ekzekutimin e ish-policit Boran Bërçana dhe bashkëjetueses

min e tritolit në qendër të Shkodrës, që shkaktoi terror, plagosi kalimtarë dhe vetë Lul Kulla u dëmtua rëndë. Në të vërtetë, sipas një burimi të "ABC News", Boran Bërçana nuk e kishte deklaruar një fakt të tillë dhe ai nuk kishte pasur lidhje me ngjarjen. Pas verifikimeve, ai

ndodhej në Spanjë, për llogari të një grupi kriminal, por vendimi i ekzekutimit ishte marrë. Dhe jo vetëm për ish-policin, por edhe për bashkëjetuesen e tij, që cilësohej si person që kishte dijeni për shumë ngjarje. Mbi ta u shitinë 28 plumba, por femija i vogël i tyre shpëtoi, sepse

ndodhej në sediljen e pasme. Ngjarja ka ndodhur në korrik dhe asnjë i dyshuar nuk është në pranga. Hetuesit nuk kanë gjetur asnjë provë ligjore, as në vendin ku ndodhi ekzekutimi dhe as në makinën e autorëve, e cila u gjet e djegur në "By-Pass". /abcnews.al

Ish-truproja e Berishës, apel për ndihmë ambasadës turke dhe amerikane

TIRANË

Izet Haxhia, ish-truproja e Sali Berishës, deklaroi se nga sot do të nisë grevën e urisë në burg. Në një postim në "Facebook", thuhet se kërkesa zyrtare e tij për këtë vendim iu dorëzua dje drejtorisë së burgut. Nuk dihet kush e ka shkruar postimin në "Facebook" -un e tij, pasi duhet thënë se disa prej postimeve janë shkruar edhe nga e dashura e tij, Erjona. Në njoftim thuhet Izet Haxhia do ta ndër marrë këtë akt ekstrem pas kërcënimeve, sipas tij, që ka marrë nga shefi i policisë së burgut 302. Në 2006-n, Izet Haxhia u arrestua në Turqi, ndërsa në maj të këtij viti ai u ekstradua në Shqipëri për të vuajtur dënimin me 25 vite burg që ka marrë nga të gjitha shkallët e gjyqësorit shqiptar për bashkëpunim në vrasjen e deputetit Azem Hajdari.

POSTIMI I PLOTË

Nga dita e nesërme, Izet Haxhia hyn në grevë urie! Kërkesa zyrtare e tij për këtë vendim iu dorëzua sot drejtorisë së burgut! Ky akt ekstrem i luftës demokratike vjen si pasojë e kërcënimeve që Izet Haxhia ka marrë dje nga shefi i policisë së burgut 302. Ky i fundit u thirr nga Izeti për të denoncuar 2 punonjëset e burgut që kryen akte të paligjshme e të turpshme gjatë kontrollit fizik të një të afërmeve të moshuar të Izet Haxhisë.

Në çdo vend demokratik, ndaj një ankese dhe akuze kaq të rëndë, shefi dhe policia, minimumi duhet të hejtojë mbi ngjarjen dhe të marrë në pyetje punonjëset e tij!

Shefi i policisë së burgut 302, jo vetëm që kishte ardhur i parapërgatitur për të mohuar gjithçka para Izetit, por edhe gënjeu duke thënë që "pashë kamerat, kontrolli ka qenë normal"...

Gënjesë sepse në dhomat e zhveshjes për kontroll nuk ka kamera! Pra, mbasi mohoi paturpësisht, gënjeu paturpësisht, më në fund, kërcënoi Izet Haxhinë duke i thënë se "tani ke për ta parë çdo të bëjmë, ta shohim që sot e mbrapa, je në dorën tonë etj". Ky qehet kërcënim jete...

Dmth., të kërcënohesh hapur nga përfaqësuesi i shtetit, sepse thjesht po kërkoni një anketë mbi 2 punonjëse... paramendoni se çfarë të

"U kërcënova nga shefi i policisë së burgut 302, sot nis grevën e urisë"

Izet Haxhia: Jeta ime është ngërç për pozitën dhe opozitën, të dyja palët më duan të vdekur



Izet Haxhia, ish-truproja e Sali Berishës

drejtë tjetër do mund të kërkojë Izet Haxhia në këtë vend!

Gjithçka është e kalbur, mafia është kudo, asnjë diferencë nuk bëhet midis pozitës dhe opozitës, kur vjen puna tek interesat e tyre!

Jeta e Izetit është një

ngërç për të dyja palët, të dyja palët e duan të vdekur! Mos kini asnjë iluzion mbi këtë...

I bëj thirrje publike avokatit të Izet Haxhisë, zotit Bashkim Nikolla, të ndër marrë hapat e duhura ligjore, në lidhje me këtë rrezik, keqtrajtimit, kërcënim dhe shkelje të

të drejtave të njeriut në mënyrën më flagrante, nga vetë shefi i policisë së burgut!

Sepse moszbatimi i detyrës së shefit për të shqyrtuar këtë akuzë të Izetit tregon hapur mbështetjen dhe krahët e ngrohta që ka shteti nga mafia kuçedër, që ka përfshirë çdo skaj të shtetit. I bëj thirrje gjithashtu zotit Nikolla të dërgojë padinë kundër Sali Berishës, ashtu siç Izeti kërkoi me ngulim!

I bëj thirrje të ankohej gjithashtu zyrtarisht, tek ambasada turke, e cila pranoi ekstradimin e shtetasit Haxhia, duke marrë garanci nga shteti shqiptar për jetën e tij!

Tek ambasada amerikane, si më e fuqishmja në Shqipëri, gjithashtu! Sigurisht që jemi para

shumë të panjohurave...

Por, diçka është e sigurt, para kalbjes dhe arrogancës së shtetit mafioz, ka edhe njerëz si Izet Haxhia (të cilin ai farë shefi e kërcënoi sikur kishte të bënte me burgaxhinjtë për drogë e për vjedhje...) që shkojnë deri në vetëflim për të drejtën dhe të vërtetën!

I tradhtuar nga vëllezër e nga ish-shokë, ai do vazhdojë i vetëm!

Ditë të rënda e të errëta priten, nëse askush s'do bëjë detyrën e tij, si nga ana e shtetit, si nga avokati e deri tek ne si njerëz të thjeshtë, etj.

Sot është jeta e Izetit në rrezik, por nesër e pasnesër, do na vijë radha të gjithëve...

Ju faleminderit të gjithëve!

Grabitje dhe rrëmbim, shqiptari kreu i bandës së rrezikshme

ITALI - Një 26-vjeçar shqiptar në Itali konsiderohet si kreu i një bande të akuzuar për vjedhje, plaçkitje dhe madje edhe një rrëmbim personi. Behet fjalë për Flori Sejdinin, i arrestuar disa muaj më parë dhe banor në Montecatini. Sipas mediave të vendit fqinj, ai akuzohet si kreu i një bande evropiane të specializuar në vjedhje dhe grabitjeve të kryera në disa zona në Itali. Në vitin 2016 banda e drejtuar prej tij kishte kryer një sërë grabitjesh në Altopascio dhe Ponte Bugianese. Këtë herë shqiptari akuzohet për 9 vjedhje me dhunë në disa apartamente. Ngjarja më e rëndë është ajo e kryer në 26 mars, ku grupi i tij përberë nga tre grabitës të maskuar hynë në vilen e një 84-vjeçari. Për më shumë se një orë ai u mbajt nën kërcënim, ndër kohë që ata po plaçkitnin duke marrë paratë dhe bizhuteritë që i përkisnin gruas së vdekur me një vlerë prej mbi 5 mijë euro. Pensionisti arriti të largohet, ndërsa identifikoi makinën, një "Renault Clio", me të cilën ikën grabitësit. Policia i ndoqi, por ata kanë post-blokuar duke aksidentuar karabinierët.

Pjesë e bandës prej 128 anëtarësh në Itali

I dënuar për drogë, lihet 40 ditë në burg pedagogu Dritan Shorja

TIRANË - Gjykata e Tiranës dje vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" me afat 40 ditë për pedagogun dhe njëkohësisht doktorin e shkencave, Dritan Shoraj, i dënuar në Itali për trafik droge. 47-vjeçari, i cili u arrestua mbrëmjen e së premtes do të qëndrojë në qeli deri në ekstradimin e tij në vendin fqinj. Gjatë seancës së djeshme gjyqësore, togat e zeza kanë refuzuar kërkesën për lirimin e Dritan Shorajt. Pas vënies në

pranga, Universiteti i Tiranës ka pezulluar nga detyra pedagogu Shoraj. Në një njoftim të shkurtër për mediat, ky universitet bën me dije se Shoraj pezullohet deri në marrjen e dokumentacionit të plotë nga institucionet përkatëse. Ndërkaq, mediat fqinje, duke i referuar hetimeve të autoriteteve italiane, zbardhin rolin e pedagogut shqiptar. Sipas tyre, Dritan Shoraj ishte pjesë e një organizate me 128 anëtarë, mes tyre edhe afrikanë dhe aus-



triakë, që trafikonin kanabis nga Shqipëria drejt Italisë. Aktivitetin kriminal Shoraj e ka pasur gjatë viteve 1998-2000, ku ishte pjesë e kësaj organizate italo-shqiptare, me bazë në Venecia. Në këtë grup kriminal kanë qenë edhe 9 shqiptarë të tjerë. Dritan Shoraj u dënua në vitin 2007 nga gjykata e Venecias me 4 vite e 20 ditë burg.

Vrau me çifte bashkëshatarin, lihet në qeli 44-vjeçari

VLORE - Admir Delaj, i cili pasditen e së premtes vrau me çifte kreun e njësisë administrative Kotë, Fatmir Hadon, dje është lënë në burg pa afat nga Gjykata e Shkallës së Parë e Vlorës. Seanca gjyqësore ndaj 44-vjeçarit që akuzohet për vrasje me dashje kryesohet nga gjyqtari Hektor Harizaj, ndërsa prokuror i çështjes ishte Maksim Sota. Seanca është zhvilluar me dyer të mbyllura dhe mediat janë lejuar të qëndrojnë vetëm gjatë minutave të para. Ngjarja për të cilën akuzohet Delaj ndodhi në lokalitetin fshatit Kotë, ku ishte duke pirë së bashku me viktimën. Gjatë marrjes në pyetje nga policia, Delaj ka deklaruar se: "Nuk më kujtohet se çfarë ka ndodhur dhe çfarë kam bërë, isha i dehur. Ishim në dy tavolina të ndryshme dhe filluam t'i hidhnim fjalë njëri-tjetrit".



"Shmangën procedurat për arkëtimin e 36,573 mijë lekë të ardhura për buxhetin"

TRIANË

Kontrulli i Lartë Sh tetëor ka kallëzuar në Prokurori dy ish-regjistruer, zëvendësregjistruer dhe 5 specialistë të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në qytetin e Sarandës për shpërdorim detyrës. Sipas KLSH-së, ata kanë kryer regjistrime të pasurive në bregdet pa dokumentacionin e duhur ligjor në sipërfaqe 221271m2, me dokumente të parregullta dhe nuk kanë zbatuar kriteret e duhura ligjore për pagesa për detyrimin ndaj shtetit me dem ekonomik në vlerën 39,689 mijë lekë, kanë regjistruar objekte me leje ndërtimi e legalizimi mbi rrugë e tjetërsimin e pronës së shtetit, si dhe kanë shmangur procedurat ligjore për arkëtimin e 36,573 mijë lekë të ardhura këto të munguara për buxhetin.

RAPORTI I KLSH

Kontrulli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit nr. 327/1, datë 19.03.2018 miratuar nga kryetari, ka audituar Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, për periudhën tetor 2014 deri në shkurt 2018. Bazuar në vendimin nr.138, datë 27.09.2018 të kryetarit për shkelje të dispozitave ligjore të konstatuara, KLSH ka përcjellë për kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë, për konsumim të elementeve të veprës penale të "Shpërdorim të detyrës", neni 248 i Kodit Penal, për disa drejtues sepse:

Në 7 raste nuk është vendosur kufizimi i pasurive sipas rekomandimeve të KLSH, në regjistrimin e pasurive me leje legalizimi në ZK 2297 Ksamil, duke sjellë si pasojë tjetërsimin e pasurisë tek të tretët, aka në të pamundur arkëtimin e vlerës së konstatuar 3,528 mijë lekë, si diferencë e çmimit të blerjes së trojeve me legalizim.

Në 11 raste ka regjistruar pasuri të paluajtshme, të përfuturara me kontrata shitje nga pushteti vendor bazuar në vendime gjykatë, duke tjetërsuar pasurinë "shtet", truall me sipërfaqe totale 2726 m2, rezulton se nuk janë zbatuar kërkesat ligjore, pasi çmimi i shitjes së truallit është përcaktuar në kundërshtim me dispozitat ligjore, për rrjedhojë është shkaktuar dem ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën totale 23,238,600 lekë, shumë e cila mund të kalonte në fondin e kompensimit financiar për kompensimin e ish-pronarëve.

Në 32 raste janë kryer veprime duke lëshuar certifikata pronësie për pasuri të kufizuara më parë, ndërsa në 13 raste janë kryer veprime mbi pasuri që rezultojnë në kushtet e kufizimit, duke i tjetërsuar ato tek persona të tretë, pa u plotësuar kushtet për të cilat është vendosur kufizimi dhe lejuar që të bëhen objekt mashtrimi dhe abuzimi.

Në një rast në Ksamil në mungesë të dhënave dhe dokumentacionit ligjor kanë regjistruar sipërfaqe toke tepër prej 20000 m2, në mospreritje me proces verbalim e dorëzimit dhe planvendosjen e VKKP nr.324, datë 10.09.2008 të AKPP Qarku Vlorë.

Në 3 raste, në bazë të lejes së legalizimit dhe leje ndërtimi kanë regjistruar pasuritë palate, duke mos zbatuar kërkesat ligjore lidhur me regjistrimin e sipërfaqeve të përbashkëta, pasi në mung-

Abuzimi i pronave në bregdet, KLSH kallëzon 2 ish-drejtorë dhe 6 zyrtarë në Sarandë

"Gjatë periudhës 2014-2018 kryen regjistrime të pasurive pa dokumentacionin e duhur ligjor në sipërfaqe 221271 m²"



eshtë akteve nënligjore, nuk është përcaktuar procedura që duhet të ndiqet nga specialistët e ZVRPP-së, për të bërë të mundur zbatimin e këtij detyrimi ligjor, për rrjedhojë nuk janë regjistruar sipërfaqet e përbashkëta, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, në vlerën totale 8,661,700 lekë, si dhe nuk janë regjistruar balkonët si pjesë e njësisë apartament apo njësi shërbimi.

Në një rast është regjistruar marrëveshje zhvillimi fshati turistik në Ksamil, pa u logarituar dhe pa u arkëtuar penalitete në vlerë 7,780,000 lekë, penalitet i pallogaritur e papaguar në buxhetin e shtetit për mospërfundim e kompleksin brenda afatit të përcaktuar në marrëveshje, dhe mospagesë qiraje në vlerën 13,333,375 lekë.

Në një rast është regjistruar marrëveshje me subjekt trajtuar si "Person i Stimuluar" dhe dhënë konfirmimi për legalizim mbi trefshin e bazës së objekteve të ndërtuara në fshat turistik prej 2766 m2, me përfitim të paligjshëm në sipërfaqe tepër prej +201271 m2 tokë shtet.

Në 7 raste kanë regjistruar pasuri truall dhe ndërtesë Bashkia Delvinë, të përfuturara me vendime të pushtetit vendor (kur nuk zotërohen akte pronësie), mungon dokumenti që vërteton shlyerjen e detyrimit financiar për truallin e përfutur.

Janë konstatuar 1354 praktika me të ardhura të përfuturara pa dhënë shërbimin e faturoar, kërkesa në proces të pa përfunduar prej 2-3 vitesh deri në 01.03.2018, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, sepse sjellin si pasojë mungesën e transparencës së punës ndaj publikut dhe mosfunksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm lidhur me integritetin e punonjësve.

Në 20 raste kanë regjistruar pasuri të paluajtshme dhe kanë kryer transaksione, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi është regjistruar në favor të poseduesve të

AMTP-ve, tokë me sipërfaqe totale prej 22480 m2, më tepër, se sipërfaqja takuese e përcaktuar në AMTP-të përkatëse pa bërë diferencën LN-AMTP.

Në 36 raste ka regjistruar në sistem fillestar pasuri të paluajtshme të përfuturara nga privatizimi, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi shitja e truallit në funksion të objektit të privatizuar, me sipërfaqe totale 16134m2, me dem ekonomik në vlerën 4602,592 lekë, nuk është kryer nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, por nga Këshilli i Rrethit Sarandë, i cili nuk ka tagër ligjor për shitjen e truallit. Ndërkohë janë kryer veprime duke lëshuar certifikatë pronësie, në kushtet e kufizimit.

Në 7 raste kanë regjistruar pasuri të paluajtshme, të përfuturara me kontrata shitje nga pushteti vendor Bashkia Sarandë, jashtë tagrit ligjor, duke përfshirë edhe pasuria "shtet", e llojit "rrugë" shkëmb, me sipërfaqe totale 6014 m2.

Në 8 raste regjistruar pasurinë në kushtet kur truallit bie dhe është hedhur në hartën e punës mbi rrugë me sipërfaqe 7776 m2, duke u mbivendosur me këtë pasurinë rrugë.

Në 57 raste me sipërfaqe 8906m2, ka regjistruar objektet palate vetëm mbi bazën e dokumentacionit të legalizimit, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi mungon dokumentacioni ligjor urbanistik dhe dokumentacioni teknik ligjor i ndërtimit, për objektin e ndërtuar sipas lejes së ndërtimit, i cili në këtë rast shërben si akt administrativ për regjistrimin e objektit, si dhe vërteton ndërtimin e objektit në përputhje me kushtet teknike, duke dhënë siguri për të funksionuar sipas destinacionit të përcaktuar.

Në 20 raste kanë regjistruar pasuri truall në funksion të objekteve, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi këto troje janë përfutur me kontrata shitje nga pushteti vendor, të cilat nuk mund të shërbejnë si akte për fitimin

MARRËVESHJA PËR KSAMILIN


Kontrulli i Lartë i Shtetit thekson se në një rast është regjistruar marrëveshje zhvillimi fshati turistik në Ksamil, pa u logarituar dhe pa u arkëtuar penalitete në vlerë 7.780.000 lekë, penalitet i pallogaritur e pa paguar në buxhetin e shtetit për mospërfundim e kompleksit brenda afatit të përcaktuar në marrëveshje dhe mospagesë qiraje në vlerën 13,333,375 lekë.

e pronësisë, si dhe në 11 raste, janë kryer veprime mbi pasuri truall që rezultojnë në kushtet e kufizimit.

Në një rast kanë kryer veprime për pasurinë e paluajtshme regjistruar në (KPP), në kushtet kur ka pretendime, lidhur me pronësinë mbi truallin ku është ngritur ndërtesa, pjesërisht apo plotësisht dhe palët kanë qenë në proces gjyqësor, ndërkohë që janë

kryer veprime dhe pajisur me certifikata pronësie.

KLSH i ka kërkuar kryeregjistruerit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe marrjen e masave disiplinore për 5 punonjës: L.H., me detyrë ish-zv. regjistruer, aktualisht specialist hartograf, R.A., me detyrë regjistrim, K.K., me detyrë specialist jurist L.D., me detyrë specialist dhe K.F., me detyrë specialist, për znj. A.SH., me detyrë ish-regjistruer, J.A., me detyrë ish-regjistruer L.H., me detyrë ish-zv. regjistruer, aktualisht specialist hartograf, znj. R.A., me detyrë përgjegjëse e sektorit të regjistrimit, znj. E.A., me detyrë ish-specialist juriste, znj. L.D., me detyrë ish-specialist juriste, znj. E.V., me detyrë ish-specialist juriste, të cilët në mospërbushje të detyrës së tyre funksionale dhe në shkelje të dispozitave ligjore, kanë konsumuar elementet e veprës penale të "Shpërdorim të detyrës", të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, KLSH ka përcjellë me shkresë nr:327/15 prot., datë 06.10.2018 indicie për kallëzim penal Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë të gjitha provat dhe dokumentet përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJII POSAÇËM I APELITIMIT

RISHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelitimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikes dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikes dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit" nishpall vendin vakant për pozicionin:

"Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun

KËRKESAT TË POSAÇMË:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip;
2. Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
3. Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

KUSHTET TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë afërsi për tu përshatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 12 nëntor deri më 21 nëntor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 21 nëntor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 12 nëntor deri më 21 nëntor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) origjinal ose të notuarizuar. Diplomën që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislatcionit në fuqi;
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimin, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuar me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.

KËSHILLI BASHKIAK RELACIONET

Mbledhja e Këshillit Bashkiak të Tiranës/ Buxheti, përfitojnë personat në nevojë

Projektvendimi, zbardhen emrat e fituesve të bonusit të strehimit

Lista e plotë e familjeve që do të subvencionohen 100%

Voltiza Duro

Në datën 15 nëntor do të mbahet mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, ku pritet miratimi i projektvendimit për trajtimin me bonus strehimi për familjet në nevojë, që nuk përballojnë dot qiranë e tregut. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot emrat e 212 aplikantëve, ku 83 prej tyre kanë dorëzuar dokumentacion të rregullt dhe kështu mund të njihen edhe me masën e përfitimit që iu takon. "Për të zgjidhur problemet e strehimit në qytetin e Tiranës, Bashkia e Tiranës me qëllim ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave është duke ndërmarrë projekte të rëndësishme, që do të krijojnë zgjidhje përfundimtare për strehimin nëpërmjet ndërtimeve të banesave sociale me qira", theksohet në relacion. Në kuadër të këtij projekti, Bashkia e Tiranës po vijon me zbatimin e ofrimit të bonusit të strehimit, që përcakton një shumë të ardhurash mujore, që i takojnë një familjeje si ndihmë nga shteti, për të mbuluar pjesërisht pagesën e qirave të tregut të lirë. Bonusi i strehimit jepet nga njësitë e qeverisjes vendore, me miratim të këshillave të tyre. Ndërkohë, Drejtoria e Strehimit Social parashtrohet se do të punojë aktualisht me vendimin nr. 15, me qëllim zgjidhjen emergjente për kategoritë sociale që kanë aplikuar për bonus strehimi.

KËRKESAT


"Nisur nga fakti se numri i kërkesave të familjeve në nevojë për trajtim me strehim për subvencionimin e qirasë së banesës është shumë i lartë dhe në rritje, dhe nga ana tjetër ende nuk kemi zyrtarisht të dhëna mbi vlerën e çmimit të qirave minimale në treg, kërkojmë vlerësimin për miratim të listës emërore të familjeve për trajtim me bonus strehimi. Në kuadër të trajtimit me bonus strehimi, pranë Drejtorisë së Strehimit Social kanë dorëzuar dokumentacionin për të përfituar nga kjo alternativë gjithsej janë 212 aplikantë/familje, ku ndër to rezultuan 88 apli-

kantë/familje me dokumentacion të rregullt". - thuhet në projektvendim. Gjithashtu 10 aplikime i përkasin komunitetit rom, që preken nga zbatimi i projektit "Unaza e madhe e Tiranës", segmenti Komuna e Parisit-Rrugë e Kavajës, të cilat janë dorëzuar pranë Bashkisë së Tiranës përpara hyrjes në fuqi

të vendimit të sipërcituar: **SUBVENCIONIMI 100%**

Gjithashtu, në projektvendim theksohet se 83 familjet fituese do të trajtohen me subvencionim në masën 100% të qirasë. "Efekti financiar për 83 familje, të cilat kanë rezultuar me dokumentacionin e plotë, do të përballohen

nga fondi për "Bonuset e strehimit" të parashikuar në buxhetin e Bashkisë së Tiranës, në shumën prej 1138023 lekë në muaj. Sa më lart, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë", theksohet në projektvendim.



EMRAT E FITUESVE TË BONUSIT TË STREHIMIT

Emër	Atësia	Mbiemër	Shuma që përfiton	58. Gjeta	Tome	Toma	15 000 lekë	85. Mimoza Deliu
1. Ylli	Firduz	Ganaj	6 900 lekë	59. Myzejen	Nexhip	Groni	6 722 lekë	86. Kristina Qose
2. Elisabeta	Qamil	Musi	10 000 lekë	60. Elisabeta	Jani	Shabi	11 790 lekë	87. Feti Bahollari
3. Seldi	Avdyll	Maçka	20 000 lekë	61. Hamez	Arif	Mehmetaj	15 000 lekë	88. Danjel Shaku
4. Demokrat	Avdi	Lloçi	18 500 lekë	62. Aleksandra	Fatbardh	Meta	20 000 lekë	89. Bukurije Zeneli
5. Suzana	Sami	Myrteli	24 255 lekë	63. Engjellush	Rustem	Xhelaj	6 960 lekë	90. Zenepe Sinani
6. Çetina	Sami	Elezi	20 000 lekë	64. Endri	Sami	Balli	15 000 lekë	91. Suela Likometa
7. Kristina	Sherif	Turbhani	18 000 lekë	65. Shpresa	Ali	Zenelaj	6 960 lekë	92. Nafije Hafizi
8. Nafije	Shyqyri	Hafizi	25 000 lekë	66. Guxim	Ajet	Gogya	18 000 lekë	93. Dallëndyshe Gjoni
9. Luljeta	Bajram	Berisha	20 000 lekë	67. Vjollca	Nikolle	Lula	12 000 lekë	94. Migena Toli
10. Sonila	Sefedin	Shukri	6 960 lekë	68. Gani	Gani	Zylfo	6 960 lekë	95. Sllibodanka Shtishi
11. Ymer	Ramazan	Koliqi	9 187 lekë	69. Alma	Enver	Petritaj	16 870 lekë	96. Majinda Ndoj
12. Regjina	Zef	Nushi	11 790 lekë	70. Selvie	Xhevrit	Ibrahimllari	20 000lekë	97. Nexhmije Fejza
13. Raimonda	(I panjohur)	Qëndro	11 790 lekë	71. Mimoza	Nexhip	Groni	6 960 lekë	98. Zef Gjoka
14. Frederik	Faslli	Hamitaj	6 960 lekë	72. Liri	Qemal	Metushi	9 513 lekë	99. Engjellush Xhelaj
15. Fatime	Tahir	Peta	6 960 lekë	73. Rudina	Sefedin	Merepeza	6 960 lekë	100. Lulezime Mile
16. Advijë	Iljaz	Hasimi	20 000 lekë	74. Shqiponjë	Remzi	Buzaj	6 960 lekë	101. Reoland Haris
17. Lindita	Fehmi	Dangëllia	25 000 lekë	75. Evionda	Pëllumb	Canaj	15 000 lekë	102. Shaqir Haris
18. Ferit	Ismajl	Pemaj	11 790 lekë	76. Dule	Murat	Kalemasi	15 000 lekë	103. Arben Karaj
19. Sokol	Remzi	Caka	11 790 lekë	77. Luljeta	Nuri	Kanani	6 960 lekë	104. Fitim Fasho
20. Hakik	Limani	Aliaj	17 000 lekë	78. Bledi	Hysni	Avdijaj	20 000 lekë	105. Ilirjana Zyberi
21. Efronisi	Thoma	Lito	10 014 lekë	79. Iljia	Muharem	Gjoza	18 000 lekë	106. Mandi Nuredini
22. Shkëndije	Haki	Nuri	6 190 lekë	80. Irma	Eqerem	Shahini	15 000 lekë	107. Elivërsa Balla
23. Trane	Ramiz	Balla	6 960 lekë	81. Kristul	Sotir	Beqi	16 870 lekë	108. Dritan Baholli
24. Vitore	Zef	Filipi	8 000 lekë	82. Isida	Hysni	Avdijaj	20 000 lekë	109. Nikolin Ahmetaj
25. Nik	Pal	Lleshi	6 960 lekë	83. Dallandyshe	Jonus	Tanushi	10 000 lekë	110. Urim Daci
26. Zyhra	Hasan	Gjapi	20 000 lekë			Totali	1.138 023 lekë	111. Dashamir Alimeta
27. Razija	Sami	Basha	13 000 lekë					112. Griselda Mema
28. Emiljano	Nuredin	Ruqja	19 500 lekë					113. Emiljano Lame
29. Luan	Agim	Sula	16 000 lekë					114. Zef Lala
30. Ardjan	Ruzhdi	Serjani	17 500 lekë					115. Kadri Puci
31. Saimir	Nuredin	Ruqja	14 000 lekë					116. Selim Sefa
32. Flamur	Muharrem	Shupli	16 000 lekë					117. Hatixhe Hysaj
33. Ronaldo	Ardjan	Serjani	18 000 lekë					118. Ilirjan Çako
34. Muharrem	Hysen	Shupli	19 000 lekë					119. Lutfije Këmaci
35. Davit	Halit	Kovaçi	19 500 lekë					120. Shpëtim Ymerali
36. Leonard	Halit	Kovaçi	16 000 lekë					121. Pemë Kondi
37. Mira	Ramadan	Parllaku	6 960 lekë					122. Vladimir Ziu
38. Gjergj	Zef	Gjoka	20 000 lekë					123. Myzafer Lat
39. Lulëzim	Gani	Brazhdi	5 102 lekë					124. Xhire Gjoshi
40. Elvi	Bajram	Vrapj	23 000 lekë					125. Marash Maletaj
41. Izet	Gani	Kuqi	6 960 lekë					126. Natasha Tahiri
42. Elmira	Brahim	Llapi	6 960 lekë					127. Burhan Spahi
43. Anila	Jakup	Kurtaj	20 000 lekë					128. Mimoza Gavrani
44. Ina	Jemin	Balla	20 000 lekë					129. Filipi Kondi
45. Vjollca	Nazmi	Lasku	6 960 lekë					130. Majlinda Ndoj
46. Zamir	Bashkim	Demiri	15 000 lekë					131. Anila Muja
47. Nertil	Robert	Dhiamandi	18 500 lekë					132. Ada Cako
48. Shabe	Abdyll	Mneri	6 960 lekë					133. Debora Bacelli
49. Ilir	Ramadan	Dani	20 000 lekë					134. Donika Gjipi
50. Suela	Leo	Junuzi	6 960 lekë					135. Flanka Naska
51. Age	Bardhok	Pashollari	20 000 lekë					136. Qazim Vrapj
52. Burbuqe	Muharem	Memushi	11 790 lekë					137. Fluturije Hoxha
53. Skënder	Asllan	Betoja	6 960 lekë					
54. Astrit	Bashkim	Demiri	20 000 lekë					
55. Kujtim	Sulejman	Maliqi	15 000 lekë					
56. Ardian	Ramazan	Serjani	6 960 lekë					
57. Qazim	Pëllumb	Duka	6 960 lekë					

Në kuadër të trajtimit me bonus strehimi, pranë Drejtorisë së Strehimit Social, kanë dorëzuar dokumentacionin për të përfituar nga kjo alternativë gjithsej janë 212 aplikantë/familje, si më poshtë vijon:

- Elisabeta Musi
- Seldi Maçka
- Demokrat Lloçi
- Suzana Myrteli
- Çetina Elezi
- Kristina Turbani
- Nafije Hafizi
- Luljeta Berisha
- Ymer Koliqi
- Regjina Nushi
- Rajmonda Qëndro
- Frederik Hamitaj
- Fatime Peta
- Edmond Hasimi
- Lindita Dangëllia
- Ferit Pemaj
- Sokol Caka
- Huzrie Tota
- Ilir Hakik Aliaj
- Efronisi Lito
- Shkëndije Nuri
- Trane Balla
- Vitore Filipi
- Nik Lleshi
- Zyhra Gjapi
- Razija Basha
- Emiljano Ruqja
- Luan Sula
- Davit Kovaçi
- Leonard Kovaçi
- Mira Parllaku
- Gjergj Gjoka
- Lulëzim Brazhdi
- Elvi Vrapj
- Kujtim Ymeri
- Izet Kuqi
- Elmira Llapi
- Anila Kurtaj
- Ima Balla
- Vjollca Lasku
- Zamir Demiri
- Nertil Dhiamandi
- Shabe Mneri
- Ilir Dani
- Suela Junuzi
- Age Pashollari
- Burbaqe Memushi
- Astrit Demiri
- Maliqi
- Ardian Serjani
- Qazim Daka
- Elvira Sallaj
- Sonila Shukri
- Ardeta Metajaj
- Kujtim Nurka
- Qemile Nuredini
- Ardian Muharremi
- Zamir Muharremi
- Bujar Muharremi
- Përpurin Gatali
- Romeno Sulejmani
- Lindita Sberifi
- Sheradhe Kaca
- Dallandyshe Kocoku
- Festim Gici
- Armando Kacaçi
- Margalita Mullisi
- Antigoni Canko
- Xhafer Mansaku
- Horë Avdia
- Dallandyshe Tamushi
- Xhamajë Latifi
- Gjelinë Marraj
- Aisela Nano
- Irma Andrea
- Sheradhe Buzati
- Remzine Palushi
- Aristotel Tahiri



Voltiza Duro

Në mbledhjen e 15 nëntorit, pritet të miratohet edhe vendimi për dhënien e ndihmës financiare për familjet e prekura nga dëmet natyrore. "Gazeta Shqiptare" publikon sot emrat e familjeve që përfitojnë këtë ndihmë financiare si dhe masën përkatëse të parave që do të marrin. "Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja b, nenit 29, pika 1, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për emergjencat civile" të ndryshuar, Kreut III, pika 1, shkronja "b" të vendimit nr. 329, datë 16.05.2012 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2018, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak vendosi të akordojë një ndihmë financiare për disa familje", thu-

- 138. Jutbina Markaj
- 139. Festime Skepi
- 140. Bafjjar Jazaj
- 141. Lindita Arixhiu
- 142. Shpresa Koroveshti
- 143. Median Murati
- 144. Haxhire Senko
- 145. Xhevahi Kamberi
- 146. Elida Balla
- 147. Fatime Kovaçi
- 148. Agim Basha
- 149. Meliha Lala
- 150. Shefjon Çollaku
- 151. Shpëtim Latifi
- 152. Vjajana Dardha
- 153. Hatixhe Laze
- 154. Kujtim Labaj
- 155. Hilda Gjipi
- 156. Donika Gjipi
- 157. Xhovanin Marku
- 158. Rexhino Lufta
- 159. Marsela Brahimi
- 160. Marije Deda
- 161. Zamira Balla
- 162. Silvana Shurdha
- 163. Kadri Çuka
- 164. Lirije Muja
- 165. Dritan Muçanji
- 166. Stela Krasniqi
- 167. Shpresa Mullalli
- 168. Fatjon Cane
- 169. Edlira Biba
- 170. Klodiana Bakiaj
- 171. Hane Gjella
- 172. Elisabeta Liçi
- 173. Fitim Fasho
- 174. Qemal Idrizi
- 175. Elez Preçi
- 176. Arjana Karroj
- 177. Lefteri Shollo
- 178. Elona Muharemi
- 179. Elida Naqellari
- 180. Mirela Selmani
- 181. Elton Emini
- 182. Margalina Mullisi
- 183. Lumturije Cili
- 184. Gjeta Toma
- 185. Myzejen Grori
- 186. Elisabeta Shabi
- 187. Hamez Mehmetaj
- 188. Aleksandra Meta
- 189. Engjellush Xhelaj
- 190. Endri Balli

Relacioni pret miratimin në mbledhjen e 15 nëntorit, buxheti i vënë në dispozicion

Familjet e prekura nga dëmet natyrore, kush do të përfitojnë ndihmë financiare

Zbardhet relacioni, sasia e parave që do të marrin të dëmtuarit

EMRAT E FAMILJEVE PERFITUESE	
Të akordojë një ndihmë financiare për familjet e poshtëshënuara :	
1. Z. Haxhi Mici, 178, 926 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e njëzet e gjashtë) lekë.	
2. Z. Shehat Sada, 51, 570 (pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë.	
3. Z. Mitat Dymishi, 267, 361 (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e dyzet) lekë.	
4. Z. Shyqyri Muzhaqi, 257, 361 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë.	
5. Z. Ylli Seitaj, 142, 620 (njëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e njëzet) lekë.	
6. Z. Edmond Xhebrahimi, 16, 710 (gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë.	
7. Z. Muharrem Karaj, 78, 798 (shtatëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.	
8. Z. Roç Karaj, 214, 799 (dyqind e katërmëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.	
9. Z. Tahir Vladi, 78, 082 (shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë e dy) lekë.	
10. Z. Kujtim Braholari, 62, 079 (gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e nëntë) lekë.	
11. Znj. Pashako Zito, 69, 693 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.	
12. Znj. Qazime Hoxhallari, 83, 593 (tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.	
13. Znj. Liljana Mama, 323, 000 (treqind e njëzet e tre mijë) lekë.	
14. Znj. Anila Gjonaj, 379, 500 (treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë.	
15. Znj. Fatmira Berisha, 402, 500 (katërqind e dy mijë e pesëqind) lekë.	
16. Z. Shemzi Mata, 111, 287 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.	

het në projektvendim. SHQYRTIMI DHE FONDI

Pas shqyrtimit të dëmeve në banesat e familjeve që ndodhen brenda territorit të Bashkisë së Tiranës, u vendos që efektet financiare të këtij vendimi të përballohen nga fondi i emergjencave i parashikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2018-ën. "Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësie Administrative dhe Emergjencave Civile, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit nga institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë", theksohet në relacion.

Ja në cilat shkolla do të merret pagesa ditore

Kompensim ushqimor në shkolla për fëmijët e familjeve në nevojë, kriteret që nevojiten

Një tjetër projektvendim pret miratimin në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak. Përkatësisht do të kompensohet ushqimi për fëmijët e familjeve në nevojë në shkollat ku implementohet projekti pilot "Bëjmë Detyrat e Shtëpisë". Ky kompensim ushqimor do të shtohet masë së ndihmës ekonomike.

KRITERET

"Nxënësit përfitues të kompensimit ushqimor duhet të plotësojnë njërin nga kriteret si më poshtë: Nxënës që vijnë nga familje të cilat përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike; Nxënës që vijnë nga familje që përfitojnë ndihmë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % nga buxheti i Bashkisë Tiranë; Nxënës që vijnë nga familje që përfitojnë ndihmë nga fondet e buxhetit vendor të Bashkisë Ti-

ranë", theksohet në projektvendimin e Këshillit Bashkiak. Efektet financiare të këtij vendimi, do të mbulohen nga fondi i vënë në dispozicion në programin e Kujdesit Social, në zërin Kompensim për fëmijët në nevojë në shkolla (ushqim me vete), në buxhetin e vitit 2018, aparati i Bashkisë. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi janë ngarkuar Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë. Përzgjedhja e shkollave që po

pilotohen është bërë mbi bazën vlerësimit të infrastrukturës së nevojshme dhe kapacitetit fizik të shkollave, të 4 shkollat e përzgjedhura kanë infrastrukturën e duhur dhe funksionojnë në një turn. 4 shkollat e përzgjedhura janë: shkolla 9-vjeçare "Hasan Tahsim" NJA 2 dhe nxënës të shkollës 9-vjeçare "Fan Noli" që zhvillojnë mësim tek shkolla "Hasan Tahsim", Shkolla 9-vjeçare "Ardian Klosi" NJA 4, Shkolla 9-vjeçare "Betim Muço" NJA 6 dhe shkolla 9-vjeçare "E Kuqe". Kompensimi për kuota ditore të ushqimit do të jetë 160 lekë



Foto ilustruese

në ditë. Kuota me këtë vlerë përfaqëson racionin ushqimor ditor për çdo fëmijë që do të përfitojë nga ky projekt në shkoll-

lat që janë pjesë e projektit pilot "Bëjmë Detyrat e Shtëpisë", i cili zhvillohet nën kujdesin e MASR./ **vo.du**

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 8 / 58 + 1 - 4 , e Ilojit 'Apartament', volumi 3 , faqe 188, zona kadastrale 8370, me sipërfaqje totale 75 m2, në bashkëpronësi të ENGJELL LUAN TOPORE dhe NATASHA LUMAN TOPORE , me adresë: Rruga "Th. Zko", Pallati 65 / 3, Tiranë.

ÇMIMI 36.350 EURO. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 101 / 8 , "Trull + Ndërtës", ndodhur në zonën kadastrale 3096, volum 8, faqe 115, me sipërfaqje 3.200 m2, nga të cilat ndërtesa ka sipërfaqje 166 m2, në bashkëpronësi të YAHIA Muhamed Zakaria FARWATI dhe BRIXHILDA Bafjjar FARWATI, me adresë: Qereke, KRUIJE.

ÇMIMI 114.500 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

**BUXHETI
PROPOZIMI**

Ministri ka sugjeruar që të ulet niveli i pagave të tatueshme deri në 10 mijë lekë

Ahmetaj me propozim të ri: Të taten të gjitha pagat

"T'i fusim në sistem në taksë 1,5% të gjithë"

Përkundër propozimit të deputetëve socialistë për të rritur nga 30 mijë në 40 mijë pragun e pagave të patatueshme, ministri i Financave, Arben Ahmetaj kërkon që ky prag të hiqet fare, ose të ulen deri në 100 mijë lekë. Gjatë diskutimit të projektbuxhetit në Kuvend, ministri i Financave tha gjatë diskutimeve nën për nën të buxhetit të vitit 2019 mund të dilet me një propozim për uljen e pragut të patatueshëm. "Tatimin për të ardhurat personale do ta diskutojmë kur të vijmë nën për nën, besoj unë që janë 55% e të punësuarve që janë jashtë sistemit fiskal, pra nuk kontribuojnë fiskalisht përmes tatimit mbi të ardhurat personale, besoj që mund të maturojmë një propozim që ta ulim pragun nga 300 ta çojmë 100, apo t'i fusim në sistem në taksë 1,5% të gjithë", tha Ahmetaj. Por nuk bëhet fjalë vetëm për një ide, por për një nismë konkrete, pasi ai konfirmoi se propozimi tashmë ishte bërë. "Unë e kam bërë një propozim, besoj që do të diskutohet në të ardhmen që t'i fusim të gjithë kontribuesit me 1,5% të ardhurash personale dhe bëjmë gjithë gamën e të punësuarve brenda sistemit kontributiv fiskal", u shpreh Ahmetaj. Deri në 6-



Ministri i Financave, Arben Ahmetaj

mujorin e parë të këtij viti, në Shqipëri ishin rreth 1 milion e 300 mijë të punësuar. Sipas formulës së taksës progresive që është në

fuqi, pagat deri 30 mijë lekë dhe gjithë pagat e tjera deri në këtë shumë nuk taten. Nëse zbatohet kjo formulë, atëherë ulja e pragut do të

përfshinte të gjithë punëmarrësit në vend. Gjithsesi, efektet financiare nuk janë të ditura ende dhe çdo gjë do të varet nga propozi-

DEPUTETË
Pak ditë më parë deputetë socialistë në Komisionin e Ekonomisë kërkuar që pagat deri në 40 mijë lekë të reja të mos taksohen. Ata propozuan që të rritet pragu nga 30 mijë që është sot në 40 mijë lekë, si një zgjidhje që do t'u vinte në ndihmë afro 70 mijë personave që kanë këtë nivel pagash.

mi konkret që do konkludojë ministri i Financave edhe publikisht. Paga minimale në Shqipëri për efekt fiskal është 24 mijë lekë në

muaj, kështu që edhe nëse merret në konsideratë shkalla më e ulët e propozuar nga ministri i Financave për një taksim prej 1,5% të pagës, çdo i punësuar do të duhet të paguajë nga 360 lekë deri në 450 lekë më shumë në muaj si tatim mbi të ardhurat personale. Ndërkohë që pak ditë më parë deputetë socialistë në Komisionin e Ekonomisë kërkuar që pagat deri në 40 mijë lekë të reja të mos taksohen. Ata propozuan që të rritet pragu nga 30 mijë që është sot në 40 mijë lekë, si një zgjidhje që do t'u vinte në ndihmë afro 70 mijë personave që kanë këtë nivel pagash. Duke vlerësuar dhe rritjen e vazhdueshme të pagave të atyre që kanë marrë më pak deri tani dhe duke marrë parasysh faktin që rritjet kanë prekur fashën, e cila nuk paguante dhe kanë kaluar në fashë që paguajnë, ne do duhet ta rishikojmë këtë duke propozuar që fasha për të cilën fillon tatimi mbi të ardhurat të jetë 40 mijë lekë dhe jo 30 mijë lekë sikundër e kemi", - u shpreh Gjylameti gjatë prezantimit të këtij propozimi. Por ministri i Financave u shpreh kundër këtij propozimi duke theksuar se ishte kategorikisht kundër lëvizjes së dytësme nga 30 mijë në 40 mijë lekë.

Në bazën e Kuçovës, NATO do investojë 50 mln euro

Rritje pagash mbi 19 për qind për të gjithë ushtarakët



Kryeministri Edi Rama dhe ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, dje në Kuçovë

niveleve", bëri të ditur kryeministri Edi Rama. Në përmbyllje edhe të detyrimeve që lindin nga të qenurit pjesë e familjes më të madhe ushtarake në botë, Rama bëri të ditur se buxheti i mbrojtjes për vitin e ardhshëm do të rritet me 10 për qind. "Buxheti i mbrojtjes për vitin 2019 arrin faktikisht në 22 miliardë lekë, ose 220 milionë dhe përbën një rritje prej më shumë se 10% krahasuar me këtë vit", tha Rama. Kryeministri konfirmoi faktin se tashmë baza ushtarake e Kuçovës do të kthehet në një bazë moderne që do të jetë në mbështetje dhe në shërbim të forcave të NATO-s. "Morëm angazhimin e NATO-s për të investuar në këtë bazë mbi 50 milionë euro. Është investim që do të mundësojë transformimin e kësaj hapësire në një aeroport ushtarak standardesh të NATO-s", tha kryeministri Rama.



Xhaçka: Ja si do rriten pagat për ushtarakët

Baza ushtarake e Kuçovës do të shndërrohet në bazë të NATO-s në Ballkan. Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, duke folur gjatë aktivitetit për prezantimin e buxhetit të vitit të ardhshëm ka deklaruar se shumë shpejt baza historike dhe strategjike e Kuçovës do të gumëzhijë sërish nga zhurma e avionëve. Duke u ndalur të buxheti i vitit 2019, ajo ka theksuar se për mbrojtjen vjen me një rritje të konsiderueshme duke përmbyllur kështu një kërkesë të NATO-s. "Ky buxhet shkon në 1.25% të PBB duke përmbyllur njëkohësisht edhe kërkesat e Aleancës, edhe modernizimin e FA-ve, por edhe rritjen e pagave të ushtarakëve tanë".

BUXHETI
Ky buxhet shkon në 1.25% të PBB duke përmbyllur njëkohësisht edhe kërkesat e Aleancës, edhe modernizimin e FA-ve, por edhe rritjen e pagave të ushtarakëve tanë. 19% rritje page për ushtarët dhe rritje graduale për gradat e tjera deri në atë major", tha Xhaçka.

Nga fusha e aviacionit ushtarak në Kuçovë, ku mori pjesë në prezantimin e buxhetit të vitit të ardhshëm për Ministrinë e Mbrojtjes, kryeministri Edi Rama dha lajmin e mirë për të gjithë ushtarakët se pagat e tyre do të rriten me 19 për qind. Ai theksoi se bëhet fjalë për një rritje më të madhe edhe se sa ishte parashikuar fillimisht në draftin e buxhetit të ardhshëm. "Mund të themi më në fund, pas shumë e shumë vitesh, në një farë mënyrë, lënieje disi në hije për nga vlerësimi financiar, se jo vetëm do t'u bëjmë një rritje të re pagave të të gjithë atyre që janë të angazhuar në Forcat e Armatosura. Gjatë punës me draftin e buxhetit kemi mundur së bashku me ministrin e në radhë të parë, falë këmbënguljes së saj, të fitojmë debatin me Ministrinë e Financave dhe t'i kushtojmë Forcave të Armatosura një buxhet shumë më të konsiderueshëm se aq, duke filluar me një rritje page prej 19% për ushtarët dhe duke e shkallëzuar atë më tutje, sipas të gjitha

NJOFTIM
Studio Përmbarimore Zyber SHEHU zhvillon ankandin e I (Parë) për pasurinë:
a. Pasuria Nr./299+3-30, vol 1, faqja 134, ZK 8572, e ndodhur në Lagjen "Loni Dhamo", Lushnjë, e llojit apartament, me sipërfaqe 54m2, çmimi 1.920.000(Një milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë.
Ankandi zhvillohet në datë 16.11.2018 në ambientet e Studios Përmbarimore Zyber SHEHU me adresë: Pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnjë,
Cel.0682089339, osë adresën e-mail:shehuzyber@yahoo.com

Zëvendëskryeministri i Kosovës: Vendosëm taksë në mallrat serbe, do të ndërmerren veprime të tjera

"Nëse s'liberalizohen vizat, kushtëzojmë dialogun"

Enver Hoxhaj: Pse do të duhej t'i besonim BE-së që do ta bindë Serbinë?

Zëvendëskryeministri në qeverinë e Kosovës, Enver Hoxhaj ka thënë se Kosova duhet ta kushtëzojë dialogun me Serbinë, nëse nuk liberalizohen sa më parë vizat për qytetarët e Kosovës. Në një intervistë për Radion Evropora e Lirë, Hoxhaj ka folur edhe për taksën që Kosova i ka vendosur mallrave serbe, duke thënë se mund të ketë edhe masa të tjera nëse Serbia vazhdon të sillet me agresivitet ndaj Kosovës. Hoxhaj ka folur edhe për mungesën e njohjeve dhe pasivitetin e diplomacisë kosovare në këtë drejtim.



Zëvendëskryeministri i qeverisë së Kosovës, Enver Hoxhaj

Z.Hoxhaj, jeni cituar të kenit thënë se Kosova duhet të tërhiqet nga dialogu nëse nuk liberalizohen vizat. Si e kenit menduar vendosjen e këtij, kushtëzimit të kësaj, karshi Bashkimit Evropian?

Kam menduar që do të ndodhë një lloj politike e kushtëzimit, jo një lloj tërheqje. Në deklaratat e mia asnjëherë nuk ka pasur formulime për tërheqje, por, nëse Bashkimi Evropian nuk është në gjendje që t'i përbushë premtimet në raport me liberalizimin e vizave dhe ne i kemi përbushur të gjitha kriteret, nga kriteri i parë deri në kriterin e 95-të, dhe tash i mbetet BE-së, që të marrë vendim sa i takon mundësisë së lëvizjes së lirë në vitin 2019. Atëherë pse do të duhej t'i besojmë BE-së që BE-ja do të ketë instrumente që ta bindë Serbinë

KUFIRI MES DY SHTETEVE

Mendoj që marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë duhet të përfshijë disa elemente. Elementi i parë i saj është njohja e ndërsjellë. Nuk ka temë më të rëndësishme në raportet bilaterale Kosovë-Serbi, se sa njohja e ndërsjellë dhe anëtarësimi i Kosovës në OKB. Nëse Serbia ka vullnet politik që kjo të ndodh, ne jemi të gatshëm që të ulemi dhe të bisedojmë me Serbinë. Natyrisht që ka edhe tema të tjera.

që ta njohë Kosovën. Duhet të jemi realistë në një qasje të tillë.

Një lloj kërcënim i procesit të dialogut e ka bërë edhe pala serbe. A do ta përfillojë qeveria e Kosovës këtë kushtëzim?

Beogradi a do të tërhiqet nga dialogu apo jo, është çështje e tyre. Ne do ta marrim pjesë në dialog. I besojmë dialogut. Por, vendosja e taksës është diçka tjetër. Nëse Serbia bën agresion politik mbi Kos-

ovën, siç ka ndodhur në vitin 2017 dhe në vitin 2018, është e natyrshme në sjelljen politike të shteteve që ne të vendosim masa ekonomike dhe përmes masave ekonomike, ta dëmtojmë tregun serb. Nëse Serbia bën tregti me Kosovën rreth 400 milionë euro në vit dhe ky buxhet përdoret për të tërhequr njohje, ky buxhet të përdoret për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në organizata të ndryshme ndërkombëtare, ky buxhet përdoret për ta goditur imazhin e Kosovës dhe sovranitetin e Kosovës, është një sjellje normale që vendet të marrin veprime të tilla.

Sa është reale që Kosova dhe Serbia të merren vesh për kufirin mes dy shteteve?

Mendoj që marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë

duhet të përfshijë disa elemente. Elementi i parë i saj është njohja e ndërsjellë. Nuk ka temë më të rëndësishme në raportet bilaterale Kosovë-Serbi, se sa njohja e ndërsjellë dhe anëtarësimi i Kosovës në OKB. Nëse Serbia ka vullnet politik që kjo të ndodh, ne jemi të gatshëm që të ulemi dhe të bisedojmë me Serbinë. Natyrisht që ka edhe tema të tjera. Mund të jenë çështje ekonomike, çështje tregtare, mund të jenë tema energjetike, të sigurisë, mund të jenë shkaqet të cilat e kanë sjellë luftën dhe konfliktin në Kosovë, dëmet e luftës, fati i të të pagjeturve. Unë mendoj se është herët të merremi me epilogun e dialogut.

Diplomacia serbe po zhvillon një fushatë mjaft të ashpër kundër njohjeve dhe anëtarësimit të Kosovës në organizata e mekanizma ndërkombëtarë. Çfarë po bëjnë institucionet e Kosovës karshi këtyre veprimeve?

Njëri prej veprimeve që kemi ndërmarrë javën e kaluar ka qenë vendosja e një taksë në mallrat serbe, por unë besoj që do të ndërmerren edhe veprime tjera, por veprimet shtetet serioze i marrin si veprime dhe nuk i deklarojnë paraprakisht. Përtej kësaj, unë jam i mendimit që politika e jashtme e Kosovës, duhet ta parandalojë një qëllim që e ka politika e jashtme serbe dhe qëllimi i politikës së jashtme serbe ka qenë që çdo herë Kosova të mos ketë fare politike të jashtme, që i gjithë raportin me bashkësinë ndërkombëtare të kalojë vetëm përmes dialogut. Për ta zgjeruar kontekstin e politikës së jashtme, ne duhet të marrim më shumë njohje, ne duhet të aplikojmë dhe të anëtarësohemi në më shumë organizata ndërkombëtare.

SHKURT

Urdhër arresti për ish-kryeministrin Nikolla Gruevski

Policia maqedonase është vënë në kërkim të ish-kryeministrin Nikolla Gruevski, duke trokitur në portën e banesës së tij. Sipas mediave maqedonase, aksioni i forcave policore nisi pasi gjykata themelore e Shkupit lëshoi një urdhër-arrest për arrestimin e Gruevskit, i cili nuk ishte paraqitur tek autoritetet gjyqësore për t'u transferuar në burgun e Shutkës, për të vuajtur dënimin me 2 vjet burg për çështjen "Tank". Gruevski u shpall fajtor për shpërdorim të detyrës me blerjen e makinës luksoze qeveritare me vlerë prej 600 mijë euro

Thaçi takon

Putin në Paris, çfarë diskutuan

Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi është takuar në Paris me Presidentin e Rusisë Vladimir Putin. Kreu i shtetit të Kosovës ka bërë me dije se me Presidentin Putin bisedoi për normalizimin e marrëdhënieve të Kosovës dhe Serbisë. "Në Paris, takova Presidentin Putin, duke u fokusuar në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve të Kosovës dhe Serbisë për një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe të detyrueshme. Në këtë temë, Presidenti Putin ishte i qartë: "Nëse ju (#Kosova dhe #Serbia) arrijnë një marrëveshje paqësore, Rusia do ta mbështesë atë", ka shkruar Hashim Thaçi në Twitter.

Dy tërmete në detin Jon, s'ka viktima

Dy tërmete njëri pas tjetrit kanë goditur ishujt grekë mëngjesin e së hënës. Sipas të dhënave sizmologjike, tërmeti i parë ka rënë në detin Jon dhe ka qenë me magnitudë 4.6. Disa minuta më vonë, ra një tjetër tërmet me magnitudë 4.5. Tërmetet kanë rënë në një thellësi prej 10 kilometra nën tokë, duke bërë që lëkundjet të ndiheshin në Zakyntho, Patra dhe Athinë. Tërmeti i ndje edhe në jug të Shqipërisë. Nga lëkundjet sizmike nuk ka persona të lënduar, dhe as dëme materiale

ZJARRET NË KALIFORNI, 31 VIKTIMA, 200 TË ZHDUKUR

Thellohet bilanci i viktimave nga zjarret masive në Kaliforni. Autoritetet thanë se deri tani kanë gjetur trupat e 31 viktimave, por edhe më i lartë është ai i të zhdukurve, në mbi 200. Shumica e trupave të pajetë janë gjetur në zonën e banuar Paradise në veri, njëra nga dy vatrat e mëdha të zjarreve. Në total, mbi 300 mijë persona janë evakuuar për shkak të zjarreve në shtetin e Kalifornisë, pjesa më e madhe në Los Angeles.



FOTOLAJM

Pasioni për pasarelat dhe dëshira për debutim jashtë kufijve

Elda Pema:

Modelet në Shqipëri gjykohen si trupa që reklamojnë veshje

"Nuk i vendos vetes korniza, mashkulli ideal duhet të jetë inteligjent"

Egla Xhemali

Modelingun e kam pasion dhe mendoj se ka lindur me mua". Kështu e nis rrëfimin për "Gazeta Shqiptare" Elda Pema. Bukuroshja na njihet me magjinë e pasarelave që i ka ëndërruar që e vogël, për vështirësitë dhe gjykimet që hasin vajzat të cilat bëhen pjesë e tyre, për pagesat qesharake, si dhe për rëndësinë që kanë rrjetet sociale. Elda thotë se modelet në Shqipëri gjykohen thjesht si trupa që reklamojnë veshje, megjithatë ajo dhe shumë vajza të tjera besojnë se një ditë gjërat do ndryshojnë. Pema na tregoi dhe për vlerësimin qesharak që përkehet në anën financiare, si dhe për rastet kur ai mungon. Modelja na shpjegon se pse ka zgjedhur të studiojë infermierin. Shpirti i saj zbkurohet edhe më shumë kur pohon se ajo ishte rruga nëpërmjet së cilës do ishte pranë njerëzve për t'i ndihmuar. Një mashkull që të tërheqë Eldën duhet medemos të jetë inteligjent. Më tej, Pema na zbulon se po punon për të depërtuar edhe përtej kufijve. Mezi e presim debutimin e saj jashtë!

Modelingu për ty është pasion apo profesion?

Modelingu e kam pasion, i cili mendoj se ka lindur me mua. Që në moshë të vogël, gjëja që më tërhiqte më shumë ishin modelet tekса ecnin në pasarelat më të mëdha të botës. Tanimë ky pasion për mua po kthehet në një shtysë për ta bërë, pse jo një nga profesionet e mia.

Si funksionon modelingu në Shqipëri?

Modelingu, duke folur dhe nga përvoja personale, është një profesion, i cili duhet të shikohet i rëndësishëm për tregun shqiptar të punës. Nuk mendoj se po trajtohet ashtu siç duhet. Një modele në vendin tonë gjykohet thjesht si një trup që reklamon diçka, për më tepër vlerësimi që bëhet është tepër qesharak në çdo lloj aspekti. Gjithsesi, unë dhe shumë vajza të tjera e vazhdojmë modelingu me dëshirë e pasion, me shpresë se ndoshta një ditë gjërat do



të ndryshojnë.

A parajgkohen femrat e bukura?

Nuk parajgkohen femrat e bukura, por parajgkohet ajo çka ato përcjellin të tjerët. Për dikë një femër e bukur është një kukull plastike, e cila nuk ka asgjë tjetër përveç bukurisë, ndërsa dikush tjetër e sheh bukurinë e një femre si një dhuratë të Zotit. Mendoj se është çështje këndvështrimi. Për mua bukuria nuk është thjesht diçka që të kënaq syrin, por shkon më tej.

Ka pagesë të kënaqshme një modele?

Absolutisht jo. Në Shqipëri modelet nuk marrin vlerësimin e duhur për sa i përket

pagesës. Rastet variojnë nga pagesat qesharake deri në momente që nuk paguhen fare. Mendoj se është diçka që duhet rregulluar, pasi kjo po shërben si diçka që po stopon shumë vajza nga ky profesion.

A synon tregun ndërkombëtar?

Pse jo? Është diçka për të cilën po punoj, sepse synimet e mia janë gjithmonë lart e më lart. Ndoshta në një të ardhme shumë të afërt do të realizohet.

Si i sheh vajzat që e kanë shndërruar "Instagram"-in në biznes?

"Instagram"-i është një rrjet social personal. Çdokush mund ta përdorë për përfitimet e tij. Mendoj se është

diçka shumë e mirë, që na ofrohet të gjithëve si një mundësi biznesi.

Sa të rëndësishëm janë "followers"-sat? A janë më të rëndësishëm se fansat realë?

"Followers"-at janë deri diku të rëndësishëm, por jo më tepër se fansat realë. Në "Instagram" mund të kemi ndjekës, të cilët ndoshta na pëlqejnë vetëm në bazë të asaj çka ne shfaqim aty, ndryshe nga kjo fansat realë, që na ndjekin, duke na njohur për atë që jemi.

Çfarë duhet të ketë një mashkull që të tërheqë vëmendjen?

Nuk jam person që i vendos vetes korniza, por kam një pikë



të dobët, e cila më tërheq më shumë nga të gjitha dhe ajo është zgjuarsia. Një mashkull i zgjuar është gjithmonë tërheqës.

Një modele që zgjedh infermierin. Pse ke bërë këtë zgjedhje?

Edhe pse shumë e apasionuar pas modelingu që në moshë të vogël, diçka tjetër më ka tërhequr akoma më shumë. Shpirti i mirë për të ndihmuar njerëzit në lidhje me shëndetin. Është një profesion që më bën të ndihem pafundësisht mirë dhe e lumtur. Besoj se këtë punë do ta realizoj më së miri.


Përkufizimi që do i jepje lumturisë?

Lumturia është një nocion i lartë e abstrakt, që nuk mund të arrihet lehtë. Shumë njerëz pretendojnë se disponojnë shkallën e lartë të lumturisë, por kjo është thjesht një ndjenjë gëzimi, ose e çastit që mund të zgjasë, por jo pafundësisht. Lumturia mund të përjetohet një moment dhe shtysë për këtë mund të jetë një faktor i jashtëm ose brendshëm shpirtëror, që e bën individin t'i duken gjërat me ngjyra të çelëta. Të qenurit i lumtur do të thotë të jesh i vetëkënaqur. Në përgjithësi gjërat të duken më të lehta për t'u bërë, por kjo gjendje shpirtërore ka pak gjasa të përjetohet shpesh.



Noizy hoqi nga "YouTube" super hitin, shihni çfarë po ndodh me të

A ta janë dy prej personazheve më të njohur të "showbiz"-it shqiptar. Enca dhe Noizy, disa kohë më parë sollën bashkëpunimin e suksesshëm "Bow down", i cili theu rekorde shikueshmërie në "YouTube". Mirëpo së fundmi, kjo këngë u fshi nga "YouTube", edhe pse kishte mbi 100 milionë klikime. Por e dini se këngën bashkë me klipin mund ta shihni prapë në "YouTube"? Kjo, pasi një ndër fansat e dyshes ka rihedhur klipin e "Bow Down" dhe mbase nuk do ju besohet, por kënga tashmë ka kaluar milion-ëshin e parë dhe fansa nga mbarë bota, por komentojnë duke menduar se është hedhur nga dyshja. Duhet ta pranojmë se hiti ngalet hit dhe sado të fshihet në "YouTube", ende do mbetet në mendjen e të gjithëve.



Tayna më e dashuruar se kurrë, këngëtarja zbulon të vërtetën

Tayna është një prej repereve shqiptare më të komentuara të momentit, që në një kohë shumë të shkurtër arriti të bëhet pjesë e tregut muzikor shqiptar. Këngët e saj tashmë janë kthyer në hite dhe dëgjoen në çdo club. Ajo është shumë aktive në rrjetet sociale, ku ndan shpesh me ndjekësit foto e video të ndryshme, mirëpo nuk është përfolur shumë për jetën private. Ndoshta ajo ka zgjedhur të mbajë një profil të ulët lidhur me këtë gjë. Mund të mos ketë të dashur, ama është e dashuruar marrëzisht me picën, ashtu si të gjithë ne. Reperja seksi ka publikuar një foto ku shfaqet duke ngrënë një pica dhe shkruar: "Lidhja jonë është shumë e shëndetshme dhe nuk i dëgjojmë të tjerët ç'thonë".



Rasheli zë vendin e moderatores së njohur? Ja çfarë ka thënë ajo

Për shkak të punës, thujse çdo javë e shohim duke udhëtuar në vende të ndryshme. Por moderatorja e njohur u tregoi ndjekësve të saj se ka humbur avionin për në Shqipëri. Bëhet fjalë për Alketa Vejsiun, e cila ka postuar një foto në "Instagram", teksa ndodhet ende në Firence dhe se ka humbur avionin për në Shqipëri. "Kam humbur avionin dhe se di si i bëhet për sonte në darkë! Kush do ta prezantojë programin?", - shkruan Alketa në "Instagram". Të shumta ishin komentet në drejtim të Alketës dhe një prej komenteve ishte edhe ai i Rashel Kolanecit, e cila është vetofruar për të prezantuar emisionin e mbrëmjes së sotme, mirëpo i thotë gjithashtu Alketës se është e pazëvendësueshme. Do ju pëlqente ta shihnit Rashelin si moderatore?



Dikur vajzat "vdisnin" për të! Luana habit me mendimin për Shpat Kasapin

Edhe pse vitet kalojnë, këngëtarri i njohur Shpat Kasapi do të mbetet një nga meshkujt më tërheqës në "showbiz"-in shqiptar, i cili ka bërë për vete shumë vajza. Ai është mjaft aktiv në profilin e tij në "Instagram", ku publikon foto e video të ndryshme. E sigurisht që fotot e Shpatit janë të mbushura me komplimente nga fansat femra. Madje edhe moderatorja e njohur Luana Vjollca nuk ka qëndruar dot pa komentuar në foton e fundit që ka postuar Shpati në "Instagram". Kasapi ishte i ftuar të shtunën në emisionin "Shiko kush luan", ku ishte shumë aktiv në të gjitha lojërat që u zhvilluan gjatë mbrëmjes. Ai ka postuar pikërisht një foto të shkëputur nga emisionin "Shiko kush luan", dhe Luana mesa duket nuk i ka rezistuar dot dhe ka komentuar: "VII".



INTERVISTA

ROMANO MONTRONI

Miti i librarëve italianë, "një histori e madhe dashurie për mua"

Fatmira Nikolli

Ai është miti i librarëve italianë. Një personalitet në fushën e menaxhimit dhe drejtimit të librarive 'Feltrinelli', ku ka punuar për 40 vjet. Vjen në Shqipëri gjatë Panairit të Librit në Tiranë, i ftuar nga Botimet Toena dhe Instituti Italian i Kulturës për të promovuar veprën "Të shesësh shpirtin - zanati i librarshitësit" dhe për të përçarur përvojën e tij të një jete në drejtimin e të famshmeve librari "Feltrinelli". Botimi i tij ka parathënë Umberto Eco. Në intervistën e tij për 'GSH' ai flet për përvojën e gjatë, dashurinë për librin e libraritë dhe si t'i bëjmë njerëzit të lexojnë.

Ju këni ushtruar profesionin e librarshitësit, më pas atë të një trajnuesi librarshitësisht ashtu si edhe atë të një profesori universitar, dhe të gjithë këtë përvojë personale e profesionale e këni sjellë edhe përmes librave që këni shkruar. Me cilin prej këtyre profesioneve ndiheni më mirë?

Për mua është tejet e vështirë të ndaj tri komponentë - librarshitë, trajner dhe profesor -, pasi i mendoj si pjesë të një tërësie të vetme. Por sigurisht që nëse nuk do të kisha patur fatin dhe privilegjin që të njihesha me Giangiacomo Feltrinelli-n, nuk do të isha shndërruar në një librarshitë të mirë: pra nuk do të kisha pasur asgjë për t'u mësuar të tjerëve, asnjë dije për të përçarur dhe do të kisha humbur në këtë mënyrë një përvojë fantastike. Pra, "librarshitë" është profesioni në të cilin identifikohem më së miri - dhe ai është fillësja e gjithçkaje - dhe nga ana tjetër ndihem mjaft mirë edhe si trajner apo profesor: të qëndruarit mes të rinjve është pothuajse gjithmonë zbatimje dhe stimulim.

- Profesionistë me emër në botën e botimeve në Itali ju njihin si një autoritet me peshë në fushën e formimit të librarshitëseve ashtu si edhe në fushën e administrimit funksional të një librarie. Si këni aritur të fitoni këtë

Vjen në shqip "Të shesësh shpirtin - zanati i librarshitësit"



Romano Montroni

Autori: Vendet ku lexohet shumë, janë vendet ku punohet me fëmijët

vlerësim të veçantë e të cmuar në këtë fushë?

Për këtë duhet të pyesni të tjerët! Unë, thjesht, përherë kam punuar dhe vijoj të punoj, me po të njëjtën lumturi, mirënjohje dhe entuziazëm, duke zbuluar përherë mundësi aty ku të tjerët shihnin vetëm pengesa. Pra, nuk jam një njeri që bie lehtësisht pre e dekurajimit. Për më tepër, më karakterizojnë cilësi si të qenit mendjehapur dhe kurioz: më pëlqen të qëndroj mes njerëzve, të zbuloj gjëra të

reja dhe përherë jam përpjekur të përmirësoj veten time duke u përballur kryesisht me realitetet e ndryshme nga ai i imi. Më intereson, për shembull, të di se çfarë ndodh në libraritë e vendeve të tjera, të bashkërendis përvoja të ngjashme apo edhe të vjedh ndonjë sekret! Kam qenë me të vërtetë me fat: shumë njerëz janë të detyruar të bëjnë një punë që nuk e duan, unë punën time e kam dashur fort gjithnjë.

- Në mënyrë më speci-

ZANATI

Zanati ynë realizohet nga një vëmendje e vazhdueshme ndaj atyre gjërave që duken si të vogla, por që nuk janë aspak të tilla si: higjiena, shëndeti, buzëqeshja, gatishmëria, mirësjellja, gjallëria etj. Nëse e mendoni, arsyeja kryesore, pse të gjithë ne dalim nga shtëpia për të blerë një libër, dhe nuk e porosisim atë përmes internetit, është ajo e të ndjerit të atmosferës së librarisë: mundësia për të marrë librin në duar, kërkimi duke u nisur nga propozimet e librarshitësit, këshillimi për një libër të

fike a mund të na thoni se si është e mundur që emri i një rrjeti librarish të fuqizohet si Feltrinelli të lidhet në terma suksesi dhe rëndësie me emrin e një njeriu të vetëm? Ose më mirë a është e mundur të na tregoni çelësin e suksesit tuaj?


Duhet ta nis këtë përgjigje duke ju dhënë një ravijëzim të personalitetit të jashtëzakonshëm të Giangiacomo Feltrinelli-t, i cili falë intuitës, gjenialitetit dhe afësisë për të entuziazuar librarshitësit e rinj, i dha fillësit aventurës së tij, ku u përfshiva edhe unë. Ai bëri revolucion në botën e librarive: i frymëzuar nga modeli gjerman, solli në Itali, raftet dhe tavolinat e realizuara për t'i ardhur në ndihmë klientit, ideoi formimin e librarshitëseve dhe i konceptoi libraritë si një vendtakim dhe një vend ku qarkullimi i ideve ishte element thelbësor. Një punë kjo e cila pas vdekjes së tij u vazhduar në të njëjtën lartësi nga e shoqja e tij Inge dhe i biri Carlo. Ndoshta kujdesi për detajet, pasionin dhe shija e punës së kryer më së miri ishin elementet që unë i zotëroja, por pa dyshim që

ai më dha mundësinë që të fitoja vetëdije mbi to dhe këto karakteristika t'i zhvilloja më së miri. Është e ngjashme me vezën e Kolombit, sekreti ishte aty: të punuarit me pasion dhe dhënia e vëmendjes së duhur gjithçkaje. Me siguri që nuk do bëja më shumë se sa kam bërë për Feltrinelli-n edhe sikur libraritë të kishin qenë të miat dhe vërtet lidhja me to ka qenë një histori e madhe dashurie për mua. Këtë ndjesi jam përpjekur që t'ua përçoj të gjithë librarshitëseve që kam trajnuar dhe me të cilët kam punuar: do të shtoja se janë ata që i kanë dhënë emrin librarive Feltrinelli, aq shumë sa për një periudhë të gjatë emri Feltrinelli lidhej më së shumti me libraritë se sa me shtëpinë botuese. Madje në një moment krize vetë mbijetesë dhe shtëpisë botuese u mbështet fort në fuqinë e librarive.

- Për një botues profesionist, libreria mbetet vendi i duhur ku autori takohet me lexuesin e tij. Si një pjesë e rëndësishme e të gjithë sistemit botues, libreria ka funksione jo vetëm informuese, por edhe ekonomiko-financiare. Por, pse sipas Jush, është i rëndësishëm roli i librarshitësit në këtë zinxhir?

Libreria nuk është vetëm një sipërmarrje, por edhe një vend kulturor: nëse ajo mbështetet në një librarshitë që do dijë t'i japë jetë e gjallëri, ajo do pushojë së qeni vetëm një dyqan dhe do të kthehet në një qendër përhapjeje dhe shkëmbimi idesh. Një librarshitë i pasionuar dhe i përgatitur ka më shumë peshë se vetë kritikant letrarë për suksesin e një libri: pasi ai njeh të gjitha mënyrat për t'i dhënë shikueshmëri të lartë librit dhe për të fituar vëmendjen e lexuesit.

- Çfarë mund të gjëjë një librarshitë shqiptar në faqet e librit tuaj? Mund të na jepni disa udhëzime për një publik, i cili edhe pse



ka përvojë në këtë fushë, pra në atë të librarisë, nuk ka nga ana tjetër formimin e duhur, pasi në Shqipëri, fatkeqësisht nuk është parashikuar ende një drejtim universitar për librarshitëse?

Shpresoj që librarshitësit shqiptarë të mund të gjejnë udhëzime praktike për të përmirësuar punën e tyre të përditshme: këshilla se si duhen ekspozuar librat, si i shërbehet klientit, si përgatitet një produkt... Por kryesisht, do isha shumë i kënaqur nëse libri im do të ndikonte në të kuptuarin e çështjes se formimi i tyre është i domosdoshëm dhe që ky zanat, pra zanati ynë rrethohet nga një vëmendje e vazhdueshme ndaj atyre gjërave që duken si të vogla, por që nuk janë aspak të tilla si: higjiena, shëndeti, buzëqeshja, gatishmëria, mirësjellja, gjallëria etj. Nëse e mendoni, arsyeja kryesore, pse të gjithë ne dalim nga shtëpia për të blerë një libër, dhe nuk e porosisim atë përmes internetit, është ajo e të ndjerit të atmosferës së librarisë: mundësia për të marrë librin në duar, kërkimi duke u nisur nga propozimet e librarshitësit, këshillimi për një libër të mirë. Është i ashtuqajtrori faktori njerëzor që ka rëndësi më shumë se çdo gjë tjetër. Janë njerëzit ata që i japin vlera librave! Dhe megjithatë ju kujtoj se Shqipëria e Italia janë shumë afër: përse të mos provojmë të krijojmë një bashkëpunim me Shkollën për Librarshitë "Umberto dhe Elisabetta Mauri" (www.scuolalibrareum.it),

NUOFTIM ANKANDI

Përmbartësit e Gjyqësorës Emira Mhilli me adresë Lg. "Oemal Stafa" Rr. "Don Bosko", përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder rrijnë se nga data 12.11.2018, ora 16:00 në ambientet e saj do të zhvillohet ankandi i trete për shpëtimin e pasurisë së paluajtshme e llogj.Ndertesë,Kati i pare i perberë nga dy dhoma,banjo,korridor,sallon dhe balkoni me sip.123 m2, me nr.radhori 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne Z.K.8592.Lgj "Naim Gjybegu" Rr.Sali Nivica/Shkoder ne vleren 3.595.536 leke (Tremilion e pesëqind e nentëdhjete e pesemijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë leke)

Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Raiffeisen Bank (per pjesmarjen ne ankand)

Oftertesat te drejtohen prane Zyres se Përmbartësës Gjyqësore Emira Mhilli, ose te kontaktojnë nepërmjet Nr.tel:0692219253 ose adreses se emailit. emira.mhilli@hotmail.com

NUOFTIM ANKANDI

Përmbartësit e Gjyqësorës Emira Mhilli me adresë Lg. "Oemal Stafa" Rr. "Don Bosko", përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder rrijnë se nga data 12.11.2018, ora 16:00 në ambientet e saj do të zhvillohet ankandi i trete për shpëtimin e pasurisë së paluajtshme e llogj.Ndertesë, Kati perdhre pa ndarje Dyqan, me sip.113 m2, me nr.radhori 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne Z.K.8592.Lgj "Naim Gjybegu" Rr.Sali Nivica/Shkoder ne vleren 2.972.895 leke (dy milion e nentëqind e shtatëdhjete e dy mijë e tetëqind e nentëdhjete e pesë leke)

Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Raiffeisen Bank (per pjesmarjen ne ankand)

Oftertesat te drejtohen prane Zyres se Përmbartësës Gjyqësore Emira Mhilli, ose te kontaktojnë nepërmjet Nr.tel:0692219253 ose adreses se emailit. emira.mhilli@hotmail.com



**LIBRAT QË
NDRYSHOJNË JETËN**

Në vitin 2012 jam kujdesur për realizimin e një përmbledhje që titullohet kështu: "Librat të ndryshojnë jetën", në të cilën u kërkoja njëqind shkrimtarëve që të më tregonin mbi librin që kishte pasur një rëndësi shumë të madhe për ta. Për sa më përket mua, unë kam rënë në dashuri me librinin, para se të bija në dashuri me librat. Nisa të punoj mes rafteve që fëmijë dhe aty e zbulova kënaqësinë e leximit. Libri im i parë ka qenë "Djemtë e rrugës Pal".

itetit e kryejnë kërkimin e tyre në kompjuter dhe nuk shkojnë në raftin e duhur. Teknologjia ka ndihmuar administrimin e librarisë dhe në ditët e sotme rrjetet sociale kanë rëndësi për të mbajtur një marrëdhënie me klientelën, për të realizuar reklama si promovime, lexime, kurse të mundshme etj. Por gjithnjë bëhet fjalë për njëjtë ndihmë, pra gjithçka varet nga inteligjenca dhe ndjeshmëria e atij që i përdor ato. Pastaj, për sa i përket e-librave, fenomeni ka pësuar disa shtrëzime, si provë e kësaj është fakti se shumë botues nuk i botojnë më librat e rinj njëkohësisht në të dyja variantet (e-libër dhe në letër). E-librat nuk kanë krijuar lexues të rinj, nëse për profesionistët, tekstat konsultues dhe manualet mund të jenë më praktikë në formatin elektronik (edhe për arsye hapësire), lexuesit e tjerë vazhdojnë të preferojnë letrën, përveçse në rrethanë të veçanta, si për shembull kur janë nisur për një udhëtim të gjatë. Libri letër nuk do të vdesë kurrë,

pasi - si thoshte Umberto Eco - ai është pjesë e atyre objekteve që thjesht lindin të përkryer, si rrota dhe piruni.

- Meqenëse bota e libërashitësit është një botë fantastike që të hap mendjen dhe të mbush shpirtin, çfarë këshille do i jepnit të rinjve shqiptarë, në mënyrë që ata të afrohen më shumë te leximi?

Në të vërtetë nuk ka asgjë si letërsia për të zgjeruar horizontin personal, për të shtuar kureshtjen dhe për të ngjallur entuziazëm. Që prej vitit 2014 kam patur nderin të jem në krye të Qendrës së Librit dhe Leximit, një organ i ministrisë së të Mirave Kulturore që ka si qëllim kryesor përhapjen e librave dhe të leximit. Në kemi hartuar disa fushata kërkimore, për të kuptuar mënyrën se si mund të afrojmë italianët me librin dhe leximin dhe kuptuam se në vendet ku lexohet shumë (veçanërisht në Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani dhe në vendet skandinave) punohet kryesisht me fëmijët. Shteti investon shumë në edukimin e fëmijëve përmes leximit dhe në sensibilizimin e familjeve. Sipas të dhënave kemi kuptuar se fëmijët, të cilët rriten të rrethuar nga libra dhe mesohen që të vegjëll me të lexuarin e historive apo përallave, zhvillojnë një zakon leximi që i shoqëron gjatë gjithë jetës së tyre, duke i dhënë asaj gjallëri dhe kënaqësi. Është i njëjti mekanizëm që kishte nxjerrë në pah mjeshtri Abbado për muzikën klasike: zakoni i dëgjimit dhe dashuria për muzikën krijojnë gjatë fëmijërisë.

Veç të tjerash, treguesit e leximit janë të lidhur ngushtësisht me mirëqenien sociale dhe ekonomike të një vendi, është e evidente që të lexuarit i përmirëson! Këshilla që jap është të investohet në fëmijët, duke fu-

tur leximin me zë në programet mësimore, duke forcuar ose duke krijuar biblioteka shkollore dhe duke ndërgjegjësuar prindërit: është, gjithashtu, e nevojshme që ata t'u mësojnë fëmijëve që të kuptojnë se leximi është para së gjithash një kënaqësi, dhe para së gjithash një mundësi për t'u rritur të lirë dhe të vetëdijshëm.

- Ju mendoni që një libër mund të të ndryshojë jetën? Cili është libri që ka ushëruar te ju pasionin për librat dhe kryesisht pasionin për t'u bërë libërashitës?

Ky nuk është vetëm një mendim, por një bindje për mua. Në vitin 2012 jam kujdesur për realizimin e një përmbledhje që titullohet kështu: "Librat të ndryshojnë jetën", në të cilën u kërkoja njëqind shkrimtarëve që të më tregonin mbi librin që kishte patur një rëndësi shumë të madhe për ta. Për sa më përket mua, unë kam rënë në dashuri me librinin, para se të bija në dashuri me librat. Nisa të punoj mes rafteve që fëmijë dhe aty e zbulova kënaqësinë e leximit. Libri im i parë ka qenë "Djemtë e rrugës Pal". Fillimisht e lexoja me vështirësi, por pak nga pak nisa të hyj në brendësi të tij dhe nisa të marr pjesë në atë çfarë i ndodhte protagonistëve të tij. Dhe kjo ndodh sa herë zhytesh në lexim - duket sikur përjeton një magji që ripërsëritet pa fund.

- Mendoj që botuesit shqiptarë ashtu si edhe libërashitësit në Shqipëri do e vlerësojnë shumë përvojën tuaj të rrefyer me kaq shumë profesionalizëm, por cilat janë objektivat që do të donit të arrinit me botimin e veprës tuaj në gjuhën shqipe?

Profesioni i libërashitësit është një zanat i mrekullueshëm, që ka shanse dhe mundësi reale për t'ndikuar në kontekstin social-kultur-

LEXIMI

Në kemi hartuar disa fushata kërkimore, për të kuptuar mënyrën se si mund të afrojmë italianët me librin dhe leximin dhe kuptuam se në vendet ku lexohet shumë (veçanërisht në Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani dhe në vendet skandinave) punohet kryesisht me fëmijët. Shteti investon shumë në edukimin e fëmijëve përmes leximit dhe në sensibilizimin e familjeve.

or ku vepron. Me anë të këtij libri dua që të kuptohen kryesisht dy çështje: së pari, që libërashitësi nuk del nga hiçi, formimi i tij është thelbësor. Ky zanat, i yni është një zanat që nuk mund të realizohet sipas një mënyre standarde dhe të ngurtë, por përkundrazi kërkon një vëmendje të madhe në disa plane dhe nisma që kanë qëllime të mirëpërcaktuara. E dyta është e lidhur me faktin se, nëse nga njëra anë librarria është një sipërmarrje, pra ajo duhet të arrijë dhe të ruajë një ekuilibër ekonomik, nga ana tjetër është edhe një sipërmarrje e veçantë pasi librat janë krijime që rrefejnë shpirtin e botës njerëzore dhe kanë të bëjnë me emocionet. Që t'i shesësh ata duhet të kesh pasion, energji, dashuri për detajet, shije për punën e kryer më së miri, shpirt grupi... dhe shumë element të tjerë që do i gjeni brenda faqeve të librit tim.

- Në jetën tuaj profesionale si libërashitësi keni takuar mjaft njerëz të rëndësishëm, shkrimtarë e botues. Sa kanë ndikuar këto takime në përmirë-

simin e zanatit tuaj dhe sa e kanë shenjuar ato qenien tuaj?

Jam i bindur se harta e një jete njerëzore vizatohet nga takimet që bëjmë dhe unë kam qenë fatlum pasi, duke u nisur që nga takimi vendimtar me Giangiacomo Feltrinelli-n, atëherë kur isha pak më shumë se njëzet vjeç, falë punës sime kam pasur mundësinë të njoh njerëz të jashtëzakonshëm si: Giulio Einaudi, Valentino Bompiani, Umberto Eco, Gunther Grass, Nadine Gordimer, Doris Lessing dhe shumë e shumë të tjerë. Kam vënë re se ata më të rëndësishmit në fushën e tyre afrosheshin tek unë më shumë thjeshtësi e modesti. Një shembull fantastik i kësaj që sapo thashë: unë nuk kam shkuar në universitet si student, por të punuarit për një sigël të rëndësishme si Feltrinelli me një mendësi të hapur, më ka lejuar të grumbulloj një sërë përvojash, stimujsh dhe kërkesash që më kanë rritur jo vetëm si libërashitës, por edhe si qenie njerëzore. Kujtoj me shumë dashuri, harenë që ndieja ndërsa shkoja në Panairin e Librit në Frankfurt me Inge Feltrinelli-n, e cila më ka premtuar me gjigand të botimeve botërore dhe gjithnjë ka qenë bujare në terma konsiderate, komplimentesh dhe vlerësimit.

- Si ndiheni tani nën petkun e një shkrimtari, të cilin i duhet një libërashitës për të promovuar librin e tij më së miri? Apo keni menduar që këtë ta bëni vetë?

Duke thënë paraprakisht se nuk ndihem një shkrimtar (mbetem vetëm një libërashitës edhe pse nata guximin - me mbështetjen e duhur - që të botoj tre libra), mendoj se është gjithmonë interesante ana tjetër e medaljes: jam i lumtur që dikush tjetër më ndihmon që të kuptoj se si argumente të caktuar kanë pasur një kuptim edhe për mua vetë.

ku unë jap mësim?

- Ju e dini që zanati i libërashitësit ka ndryshuar shumë me kalimin e viteve, edhe se teknologjia po përqipet të zëvendësojë librat në letër dhe libërashitësit tradicionalë. Sipas mendimit tuaj sa mund ta ndihmojë dhe sa mund ta dëmtojë teknologjia një libërashitës?

Teknologjia është padyshim një ndihmesë, nëse përdoret në mënyrë inteligjente. Për shembull: listat me të dhëna, ndihmojnë më së miri në kërkimet bibliografike, por unë zemërohem tej mase kur përpara një klienti, libërash-

"KONGRESI I MANASTIRIT - RRUGA DREJT BASHKIMIT KOMBËTAR"

Në kuadër të 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit, pasnesër në ora 10:00, Muzeu Historik Kombëtar çel për publikun ekspozitën me titull "Kongresi i Manastirit - Rruga drejt bashkimit kombëtar". Ekspozita paraqet rrugëtimin e përpjekjeve të rilindësve për hartimin e alfabetit të gjuhës shqipe në shek. XIX dhe veçanërisht në fund të gjysmës së parë të tij. Kongresi u hap në Manastir më 14 nëntor 1908 dhe i vijoi punimet deri më 22 nëntor. Në Kongres morën pjesë 32 delegatë



me të drejtë vote, që përfaqësonin 26 qytete e shoqëri të ndryshme shqiptare brenda dhe jashtë atdheut, si dhe 18 delegatë të tjerë si pjesëmarrës pa të drejtë vote. Kongresi i Manastirit u shndërrua kështu në një kuvend të vërtetë mbarëshqiptar, në të cilin morën pjesë gjithsej delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, nga qytetet e vilajeteve të Manastirit, të

Kosovës, të Janinës e të Shkodrës, si edhe nga shoqëritë shqiptare të Bukureshtit, të Sofjes, të ShBasë, të Egjiptit, të Italisë etj. Ekspozita është e pasuruar me fotografi të delegatëve pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit, bashkë me biografitë e shkurtuara të tyre. Gjithashtu, objektet e Luigj Gurakuqit, Çerçiz Topullit e Mihal Gramenos, prezantohen nëpër vitrinat përkatëse. Ndërsa librat e autorëve Parashqevi Qiriazi, Hilë Mosi e Mihal Grameno, së bashku me gazetat origjinale të kohës, janë tepër interesante për publikun.

ARKIVAT SHQIPTARE, PJESË E PORTALIT TË ARKIVAVE EUROPIANE

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave ka njoftuar se prej pak ditësh arkivat shqiptare kanë plotësuar kriteret dhe janë bërë pjesë e organizimit më vital të Bashkimit Evropian në fushën e arkivave, "Portalit të Arkivave Evropiane". Zhvillimet teknologjike në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave përveç rezultatit konkret ndaj studiuve dhe rritjen e mundësive për shkëmbimin e materialit arkivor kanë sjellë edhe përafrimin e arkivave shqiptare me arkivat evropiane. DPA është



bërë pjesëtarë me të drejtë të plota e Fondacionit të Portalit të Arkivave Evropiane, një nisim e financiar nga Bashkimi Evropian ku janë të përfshira të gjithë arkivat e vendeve të Bashkimit Evropian dhe CEFTA-s. Ven-

dimi i marrë më 9 nëntor për pranimin e Shqipërisë me të drejtë të plota, e bën arkivin shqiptar të parin vend të Ballkanit Perëndimor pjesë e Portalit të Arkivave Evropiane. Ky pranim është për ne si shqiptarë një tregues i njohjes së përpjekjeve të vazhdueshme të viteve të fundit për modernizimin e arkivave dhe rritjen e përdorimit të teknologjisë si forma e së ardhmes në shërbimin arkivor. Po ashtu, përbën një mundësi të veçantë të shkëmbimit mbarë evropian të materialeve arkivore në shërbim të historisë kombëtare dhe historisë evropiane.

Opinioni *i* Ditës

Çështja Sandër Lleshi si një PPP banale

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... Ajo nuk ka sharmin e një precedenti, nëse kreu i shtetit ka kompetenca t'i refuzojë anëtarët e kabinetit të një shumice të zgjedhur me votë; ajo nuk ka as seriozitetin e debatit mes juristësh me pikëpamje të ndryshme; ajo nuk evokon as aspiratat demokratike të balancimit mes pushteteve.

Ajo është thjeshtë një shenjë më shumë që na tregon mënyrën se si qeveris Edi Rama.

Korrespondenca e sotme e shkëmbyer mes Ramës dhe Metës e tregoi hapur këtë gjë.

Aty fillimisht dallohet qartë se Presidenti e ka refuzuar dekretonin e parë të kandidaturës për ministër të Brendshëm thjeshtë për faktin se ai ishte gjeneral ende në detyrë. Dhe meqë Kushtetuta jonë e pengon që një anëtar kabinetit të kryejë edhe detyra të tjera, kreu i shtetit nuk e ka firmosur atë.

Por, pas letrës publike të Metës është tejet interesante të lexohet kundërpërgjigja e Ramës. Ai që e akuzoi vëllain e tij armik se po shkelte hapur Kushtetutën, në



përgjigjen e sotme është tërhequr ndjeshëm. "As unë as ti nuk jemi juristë" thotë në mënyrë të divulguar Rama, duke pranuar se ekspertët ligjorë të kryeministrit bëjnë një interpretim të ndryshëm nga ata të presidencës.

Pra, pasi e akuzoi Metën për një krim madhor shkelje kushtetute ai tani si pa të keq thotë se ende nuk i dihet kush ka pasur të

drejtë.

Por më e bukura vjen më pas. Ajo qëndron te zgjidhja që ofron Rama.

Me pak fjalë ai thotë: "Unë ndryshe nga presidenti nuk e pranoj që Lleshi ka qenë ushtarak ende në detyrë, por kjo s'ka problem. Ai le të japë dorëheqjen si gjeneral dhe Meta t'i hapë rrugën për ministër".

Dhe mbi këtë logjikë absurde, ai e detyroi edhe kandidatin për ministër të Brendshëm, - që në 'Opinion' shprehu një adhurim të pakufishëm për shefin e vet - të shkruajë letrën më absurde që mund të bëjë një zyrtar: atë të dorëheqjes nga një gjë që nuk pranon se ka qenë.

Pra, e thënë shkurt: qëllimi justifikon çdo mjet.

Është pikërisht ky lloj të arsyeve që na tregon për mënyrën kriminalisht sipërfaqësore me të cilën e drejton shtetin Edi Rama. Ajo nuk ka lidhje as me një debat konstitucionalistësh as me përkufizimin e vijave ndarëse mes institucioneve.

Mënyra se si Rama do të zgjidhi emërimin e Sandër Lleshit për ministër, i ngjan metodave që ai përdor për të grabitur me koncesionet dhe PPP-të.

Ajo është njësoj me mendësinë: na duhet toka publike e teatrit për kulla, hajde bëjmë një ligj special që e tejkalon kuadrin ligjor; na duhet të grabisim toka në bregdet, hajde shpallim investitorë strategjikë; na duhet t'i japim klientëve tanë check-up-in apo inceneratorët, hajde bëjmë një garë pa konkurrentë.

Pra, në thelb, ajo është një përdhosje e çdo ligji dhe rregulli vetëm e vetëm për të mbërritur tek synimi.

Prandaj të gjithë ata që janë ekzaltuar se po bëheshin dëshmitarë të një debati sqimëtar dhe me peshë, sërisht do mbeten të zhgënjyer. Sepse në gjenezë ai u prodhua nga po i njëjti Ramë, tërësisht banal si gjithmonë.

Lapsi.al

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Opinion *i* Ditës

Kur Basha e pëlqen, pse nuk e bën shqiptonjën tatuazh?

Nga Julian Zyla

(vijon nga faqja 1)

... pëlqenin francezët këtë kujtesë se cili është flamuri i tyre kombëtar? Edhe nëse do të ishte ngritur në një përvjetor, me gjasa, një pjesë e madhe e njerëzve me sens estetik normal do të prisnin diçka më krijuese sesa thjesht flamurin e ngurtësuar. E njëjta gjë do të ndodhte edhe në Romë apo Berlin. Dhe, për më tepër, shqiptonja pa sfondin e kuq nuk është as flamuri ynë kombëtar i ngurtësuar, por thjesht një tatuazh gjigant në vendin mbetur lakuriq nga një investim i munguar. Investim me anë të të cilit shqiptarët, nga të gjitha trojet, do të mund të shkonin më shpejt te skulptura kombëtare e vërtetë, ajo e Gjergj Kastriot Skënderbeut!

Në vend të investimit, shqiptarët u sollën vërdallë me një tatuazh, por jo në trupin e pushetarëve. E ndërsa i vinin përgark tatuazhit, njerëzit e duruan dhe u mësuan me të. Ndërkohë, flamuri kuq e zi nuk respektohet më pak nga ata që nuk e pëlqenin tatuazhin me rruaza. Madje, mund të jesh edhe më shumë patriot nëse arrin të pranosh dhe ndash artin e mirë dhe të keq në vendin tënd. Problemi nuk ishte shqiptonja, por mungesa e çfarëdo impenjimi artistik për realizimin e skulpturës. Nuk ishte skulpturë, por printim, në rastin më të mirë, me gjilpërë.

Por, a mbetet shqiptonja simboli ynë kombëtar dhe a është e lehtë të bësh politikë me çfarëdo deklarate që mund të bëhet të duket si e dhënë kundër simbolit? Patjetër! Kjo ishte arsyeja pse deklaratat për heqjen e saj duhet të ishin matur shtatë herë e të ishin prerë një herë.

Kryeministri nuk duhej të kish-te nisur debat për shqiptonjën tatuazh. Por ai e dinte që nuk po komunikonte me dikë që e kishte bërë mbi trupin e vetë, njerëz të cilët shfaqin hapur ndjenjë shqiptarie, por me ata që e kishin qepur mbi trupin e dikujt tjetër: këtë herë mbi atë të Tiranës. A ka Basha tatuazh shqiptonjën? (Nuk dua ta di



përgjigjen).

Thelbi i diskutimit është ky: Rama nuk duhet ta kishte bërë atë deklaratë, edhe pse nuk e kishte për simbolin, por për skulpturën, e cila më shumë e nderonte sesa e nderonte shqiptonjën me anë të përtacisë krijuese. Në këto rrethana, Partia Demokratike bëri detyrën e vetë politike duke tërhequr vëmendjen nga lakuriqësia e vërtetë patriotike: rrethrotullimi trafikndërtues.

Të luash me patriotizmin është loja më e vjetër në politikë, por politika të nxjerr në pah edhe hipokrizitë. Si do t'ia justifikojë zoti Basha dhe zoti Berisha një të riu me shqiptonjën tatuazh që këta të dy nuk e kanë, me gjasa? (Nuk dua ta di të vërtetën për tatuazhet).

Shqiptonja është simbol i dashur për të gjithë shqiptarët, por patriotizmi ka më shumë sesa simbolet që e përfaqësojnë. Patriotizëm janë investimet në të mira publike. Pa-

triotizëm janë daljet dhe jo rrethrotullimet në autostradë. Patriotizëm janë protestat paqësore, e jo shtypja e tyre me gjak. Patriotizëm është përfundimi i objekteve publike dhe jo vetëm inaugurimi.

Hipokrizia e PD në këtë rast nuk ka të bëjë vetëm me objektin e debatit: deklarata e kryeministrit. Por edhe me faktin që ndoshta vetë ata që e thonë nuk e besojnë vërtetë që shqiptonja nderonte shqiptarët. A mendon Basha dhe intelektualët e tjerë pas tij se ajo skulpturë, (pra, jo shqiptonja si simbol, por shqiptonja e artit dembel) ishte diçka që na përfaqëson-te? A jemi ne vetëm një interpretim pa interpretim i flamurit tonë?

Me siguri, të huajve mund t'u shpjegojmë që ai ishte një element i flamurit tonë. Por a mund të shpjegohej pse kjo ishte një ide për skulpturë? A mund të shpjegohej pse kjo ishte një ide për skulpturë

qoftë edhe e ndërtuar për një përvrotullim të autostradë? A mund të shpjegohej pse kishte një skulpturë kombëtare dhe aq shumë trafik? Cili ishte patriotizmi: Mungesa e interpretimit artistik të hollë, apo mungesa e investimit?

Për ata që mendojnë se shqiptonja nuk duhet të ndryshohej nga forma e saj, mjafton të shohin shqiptonjën e Skënderbeut në flamurin e Ismail Qemalit. A është ndryshimi mungesë patriotizmi?

Por, me çfarë do të dalin shqiptarët nga ky debat?

Shqiptarët do të tolerojnë deklaratën (tashmë të shtrembëruar lehtësisht nga trysnitë politike të rastit) të kryeministrit. Dhe do të vijjnë vërdallë nëpër daljet e mbikalimit duke shkruar më shpejt në destinacionet e tyre. Pasi jeta e shqiptarëve ka më shumë sesa simbole. Jeta e shqiptarëve nuk mund dhe nuk duhet të manipulohet, qoftë edhe me tatuazhe politike.

HOROSKOPI

DASHI

Për ju që i përkisni kësaj shenje parashikohet një ditë me ulje ngritje dhe ku nuk do të mungojë edhe ndonjë përplasje me dikë. Megjithatë do të ketë edhe momente interesante për ju.

DEMI

Parashikohet një ditë e mirë në shumë drejtime veçanërisht në dashuri. Do të merrni shumë komplimente nga partneri duke jua bërë ditën speciale.

BINJAKET

Një ditë e mbarë sa i përket shëndetit. Energjia pozitive do ju bëjë që edhe fiziku të ndihet mirë. Çdo ditë mundohuni që të mendoni pozitivisht.

GAFORJA

Një ditë jo shumë optimale sa i përket financave. Mos u shqetësoni, sepse kjo është kalimtare. Shumë shpejt do të merrni një shumë të mirë të hollash.

LUANI

Një person duket se ndjen nevojën për praninë tuaj. Mund ta thyni ju akullin i pari që të ndiheni i plotësuar. Do të jetë një ditë e mbarë sa i përket dashurisë.

VIRGJERESHA

Sot gjithçka mund t'ju duket se po shkon kundër jush. Edhe problemet më të vogla mund t'ju duken dramë. Largojeni nervozizmin duke u marrë me sport.

PESHORJA

Duhet të tregoheni më i vendosur për të çuar përpara projektet tuaja. Intelligenza nuk ju mungon, ndaj vazhdoni me kurajë.

AKREPI

Ditë e mbarë në aspektin financiar. Investimet duken mjaft mirë. Në punë mund të keni rritje në detyrë. Tregoni kujdes me njerëzit xhelozë.

SHIGJETARI

Ndjeni nevojën për të realizuar një udhëtim pranë të dashurve tuaj. Vazhdoni përpara me këto plane, sepse do të merrni shumë gëzim.

BRICJAPI

Pjesa e parë e ditës duket pas stresante. Punët që i keni lënë në mes do jua bëjnë ditën më të ngarkuar. Këshilloheni që t'i përfundoni këto punë pa humbur kohë.

UJORI

Nuk do ju mungojë energjia pozitive e cila ju bën të ndiheni të relaksuar. Mundohuni të shfrytëzoni më mirë rastet që iu paraqiten në dashuri.

PESHQIT

Keni nevojë për ndryshime radikale në jetën tuaj. Çfarë prisni? Në dashuri kemi patur disa pengesa, të cilat do të kalohen falë aspektit planetar.

I ftuar në 120-vjetorin e federatës italiane

De Biazi rrëfen aventurën shqiptare: Autobusi kthehej në një disko



Xhani De Biazi ka qenë edhe pjesë e një paneli me emrat më të shquar të trajnimit italian, në një ceremoni të organizuar për 120-vjetorin e Federatës Italiane të Futbollit. De Biazi ishte rreshtuar përkrah Masimiliano Alegri, Antonio Kontes, Karlo Ancelotit, Masimo Karrasses, Roberto Mancinit dhe Fabio Kapelos, me secilin ka folur për zhvillimin e trajnerëve italianë dhe eksperiencat jashtë Italisë që kishin

shumë prej tyre. Vetë De Biazi ka treguar për eksperiencën e tij me Shqipërinë dhe ka folur për disa nga gjërat që ndryshonin në krahasim me atë që ishin mësuar në futbollin italian. "Hanë në mënyrë të ekzagjeruar, me disa pjata të çu-

ditshme, pasi e përjetojnë futbollin në mënyrë më lozonjare. Pastaj autobusi dukej si një diskotekë me muzikën në maksimum. Punëtori i bazës materiale e vendos, ti afrosh dhe ul zërin, ndërsa ai e ngre përsëri", tregoi De Biazi në këtë panel mes të

qeshurave të shumë prej kolegëve të tij, të cilët me siguri kanë përjetuar situata të njëjta në vende të ndryshme të botës ku kanë drejtuar. E megjithatë, ai pranon se ka mësuar shumë nga eksperiencia e tij në drejtimin e kuzezinjeve, me të cilët arriti

deri në "Euro 2016" dhe fitoi një shkikushmëri të jashtëzakonshme edhe në vendin e tij. "Nuk kam drejtuar klube të mëdha, por eksperiencia me Kombëtaren shqiptare më ka mësuar se sa më i qartë të jetë mesazhi dhe organizimi i punës, aq më shumë shanse ke që të paraqitesh mirë. Ekuilibri është thelbësor, mes asaj që dëshiron të bësh dhe të respektohet sa më shumë të jetë e mundur ritmin dhe kulturën sportive të vendit që të pret", theksoi ai.

Italiani justifikon Loret Sadikun: Më tha se do të vinte, por nuk ishte në 100% të formës

Panuçi: Kam një ekip memecësh, Mërgim Mavraj nuk është çështje

Trajneri akuzon lojtarët për mungesë komunikimi



Jeton Selimi

Kristian Panuçi duket se po jeton ditët e fundit në krye të stollit kuqezi. Trajneri italian më shumë sesa për përgatitjet e ndeshjes ndaj Skocisë, vijon të shfrytëzojë konferencat për shtyp për të siluruar lojtarët, teksa kësaj rradhe nuk ka humbur rastin për t'i cilësuar lojtarët si një skuadër "të shurdhër" dhe "memecësh", pasi jo vetëm që nuk dëgjonin detyrat, por as nuk komunikojnë me njëri-tjetrin. Ai flet dhe për çështjen "Sadiku" dhe natyrisht, përdor alibinë e dëmtimit për të justifikuar mosgrumbullimin e lojtarit.

Iu gëzon fakti që Grezda dhe Kaçe kanë gjetur rrjetat, teksa disa nga lojtarët e tjerë kanë bërë paraqitje pozitive?

Padyshim që jam i kënaqur. Të 2 futbollistët kanë gjetur motivimin për 2 ndeshjet e ardhshme. Grezda është më mirë tani se 1 muaj më parë. Jam i lumtur që tani do të vijmë në Kombëtare me entuziazmin e golave.

Refuzimi i Loret Sadikut? Unë e kisha thirrur si pjesë e ekipit kombëtar. Më ka dërguar mesazh dhe më ka shpjeguar që nuk ndihet në 100% e formës së tij. I kam thënë që nëse nuk ndihet në formë, më mirë të mos vinte. Do jetë në plane në të ardhmen. Më pas ftova Kaçen, pasi edhe Ylber Ramadani kishte dëmtim.

Përballja ndaj Skocisë? E merituar humbjen në ndeshjen e mirë. Nuk luajtëm mirë. Vuajtëm agresivitetin. Në shtëpi do jetë ndryshe. Me Izraelin nuk morëm rezultat që meritonim. Kemi pësuar 3 gola nga goditje standarde. Kanë qenë gabime femjorore. Më duket sikur po merrem me një skuadër të shurdhër. Ne kemi skuadër memecësh, që nuk flasin. Unë duhet të rri të them kujdes këtu, kujdes atje. Këtë javë të qeshim më pak e të flasin më shumë.



E kemi luksin që Kaçe të mos jetë në listën e 26 futbollistëve?

Duke ndjekur minutazhin e lojës për çdo lojtar, kam konstatuar që Kaçe nuk është aktivizuar rregullisht. Në pjesën e ndeshjeve ku është aktivizuar si titullar, është zëvendësuar. Më parë ka qenë me Italinë, ndaj e thirra. Nuk lë në shtëpi se njëri është më mirë apo më i keq, i thërrasim të gjithë. Edhe Kajën nuk e kam aktivizuar, pasi nuk luan me ekipin e tij. Në momentin që bëj listën shikoj se sa minuta kanë luajtur të gjithë lojtarët.

Si është e vërteta e çështjes "Mavraj", a ka ngjashmëri me çështjen "Çikalleshi"?

Ky nuk është një problem apo kushtëzim nga ana ime. Është rregullore e FIFA-s. Është problem i kampionatit grek, që cakton ndeshje ditën e hënë, që përkon me grumbullimin e kombëtareve. Nuk është problemi i hynë. Është fare e thjeshtë.

Problemi i golit?

Nuk jam me shpresën që do fitojmë. Me Izraelin bëmë një lojë të mirë. Shpresoj që sulmuesit të arrijnë të zhbllokohen dhe të shënojnë gol. Uzuni dhe Grezda kanë shënuar me kampionat. Është çështje që varet nga lojtarët.

Si do e zgjidhni mungesën e Hysajit, do të preferoni mbrojtjen me tre?

Me tre mbrojtës nuk luajmë. Kemi Veselin, është Balliu, edhe pse edhe ai po luan pak dhe kemi edhe një problem me Metzin, që nuk na është përgjigjur dhe nuk e dimë a është nisur Balliu. Shpresoj që Metz të tregohet serioz, sepse e njoftuam para 13 ditësh, por na thanë që duhej t'i njoftonim para 14 ditësh. Më vjen keq, sepse për Kaçen dhamë njoftim tri ditë përpara dhe nuk na krijuan asnjë problem nga Panathinaikosi. Nëse Balliu nuk vjen, do shohim për ndonjë alternativë, kemi disa të tilla. Ne duhet të fitojmë, ndoshta me 3 mbrojtës do ishte

zgjedhja më e mirë, por duhet parë që të shpikim diçka për të rrezikuar pa humbur ekuilibrat. Dua të rrezikoj për të fituar, do shkojmë "all-in", të shohim.

Nuk mendoni se ishte koha e duhur që Ajeti dhe Qaka të rikthehen në Kombëtare?

Qaka duhet të rritet pak për të luajtur në arenën ndërkombëtare, sepse aty duhet më shumë karakter. E kam hedhur në fushë tri herë, dy herë më ka kërkuar ndërtrim pas 10 minutash. Uroj ta bëjë hapin e madh, sepse përndryshe nuk më shërben. Duhet të rritet shumë si personalitet.

Iu duket i besueshëm versioni i Loret Sadikut për të mos ardhur në Kombëtare?

Unë kam biseduar me lojtarët. Është e pamundur të konstatoj nëse lojtari më thotë të vërtetën. Ia kam shpjeguar që klubi dhe Kombëtarja janë 2 gjëra të ndryshme. Uroj ta kërkojnë

Realit dhe Barcelona, por është e vështirë që ta shohin te Kasimpasa. Nëse do të vijë në Kombëtare, do të ketë mundësi të luajë në Spanjë, Itali dhe shumë kampionate të tjera të forta. Unë do të vija në këmbë e motor nga Stambolli nëse do më ftonin. Do e bëja rrotull nga Korfuzi me motor uji. Në kohën time kur më ftonin, ishte qejf edhe të shkoja një ditë para. Ai nuk më ka thënë 'jo', do mendohet. Kemi probleme se Manaj është dëmtuar. Kam parë Durmishajn dhe i kam thënë Kombëtares që ta kontaktojë. Nuk e di nëse vjen apo jo, por presim sot përgjigje.

Çfarë po ndodh me Çikalleshin?

Ka luajtur pak, bëri një gol me një ekip të kategorisë së katërt në Kupë. Kur ka qenë në formë, e kam thirrur. Është në planet e mia, por duhet të marrë më shumë minuta.

BATUTA PA KRIPË

Panuçi: çarçani iku, zëdhënesin e dua me taka e minifund!

Duket se Kristian Panuçi ka vendosur të kalojë nga detyra e trajnerit të Kombëtares së Shqipërisë në rolin e një klouini, për të cilin nuk e paguan askush. Ndryshe nuk ka sesi të shpjegohet shakaja jo vetëm pa kripë, por edhe fyese ndaj ish zëdhënësit Gerti çarçani, por edhe të gjithë gazetarëve prezentë. Në një moment Panuçi ndërpret konferencën dhe bën një batutë (që ta cilësosh si të trashë është pak), duke zyrtarizuar lajmin e qarkulluar prej gati një muaji për shkarkimin e Gerti çarçanit nga detyra, duke deklaruar se do hapet konkursi për këtë post, porse të pranishmit duhet të vijnë me taka e minifund, koment seksit dhe aspak i përshatshëm për dikë si ai, që ka përfytyruar një komb në të shkuarën me fanelën e Italisë, por duket që në Shqipëri ka gjetur terrenin e përshatshëm edhe për ta lëshuar gjuhën në këtë formë.

Mbyllet java e 13-të

Kukësi dhe Teuta "frenojnë" njëra-tjetrën

Kukësi dhe Teuta kanë mbyllur ndeshjet e javës së 13 të Kategorisë Superiore pa një barazim i cili në fakt nuk i ka ndihmuar dy skuadrat në një moment ku u duheshin pikë për t'iu bashkuar skuadrave të kreut të renditjes dhe për të mbajtur hapin e Partizanit e Skënderbeut që tashmë janë të shqëputura. Pjesa e parë pa dy skuadra të kujdeseshme taktikisht dhe

rezultati ndryshoi vetëm falë një goditje dënimi nga Teuta. Në të dytën, po një goditje dënimi solli edhe barazimin ndërsa më pas nuk kishte më skema në fushën e lojës. Dy skuadrat luajtën hapur duke sulmuar pareshtur me sulme e kundërsulme, por askush nuk kishte më saktësi para katërkëndorit kundërshtar e si rrjedhojë ndeshja u mbyll me barazimin 1-1.

SUPERLIGA

JAVA E 13-të


TË DIELEN	
Luftëtari - Tirana	1-2
Kastrioti - Kamza	3-0
Skënderbeu - Flamurtari	0-0
Partizani - Laçi	1-0

TË HENEN	
Kukësi - Teuta	1-1

RENDITJA

Skuadra	N	P
Partizani	13	31
Skënderbeu	13	29
Laçi	13	22
Teuta	13	22
Kukësi	13	21
Flamurtari	13	19
Luftëtari	13	13
Tirana	13	10
Kamza	13	8
Kastrioti	13	7

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomie e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mapupassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenja.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriark biblik.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.
32. Ekstrete në numërim.
33. Eshhtë bodrumi.

34. Steiger aktor.
35. Inicialet e Delon.
37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
38. Një mund të jetë autonome.
40. Në krye të evidencës.
42. Edgar Allan Poe.
44. Ekstrete në litar.
46. Giorgio i modës.
50. Janë malet me Akonkagua.
52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

VERTIKAL

1. Novarro qe qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.
10. Eshhtë ai që gënjën për t'u bërë i njohur.
11. Një markë celulari.
12. Ushtrohet nga fillbustierët.
16. Një përsiatje.
17. Agjenci Informative Tiranë.
21. Një brejtës pylli.
23. Një Gjon qe qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum qe qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipò
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.
34. Neill i Jurassic park.

VERTIKAL


35. E bukura e belle epoqe.
37. Qe mbreti i elfëve
39. Farrow, aktore
40. Hagen rockstar
41. Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
45. Në fund majtas
46. Mund të preken nga morbusi i Basedow
47. Ad... për të ngarkuarin me punë
48. Loach regjisor
9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos qe qe pilot i Formula 1
15. Ekstrete në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërora
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lempër, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti




9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos qe qe pilot i Formula 1
15. Ekstrete në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërora
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lempër, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti

IPË

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

1			5	2		3	8
8	3		9			2	7
4	9		7		5		
		6	9				
	2		7		4		1
6	7	4				3	
7	1	6	8				9
				4			
				6	9	1	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	8	7	2	6	9	4	5	1
5	4	2	7	3	1	8	9	6
9	1	6	4	5	8	7	2	3
2	6	3	8	9	4	5	1	7
1	7	8	3	2	5	6	4	9
4	9	5	6	1	7	2	3	8
8	2	1	5	7	3	9	6	4
6	3	4	9	8	2	1	7	5
7	5	9	1	4	6	3	8	2

Argëtim filozofik

- Arsyeja pse e quajmë "Ëndrra amerikane" është se duhet të jesh në gjumë ta besosh.
- Si ka mundësi që nuk e kuptojmë asnjëherë kur fillon dashuria, por gjithmonë e dimë kur mbaron
- Ah, ata francezët. Kanë një fjalë të ndryshme për gjithçka!
- Azia: Katër shkronja të vogla, tre miliardë njerëz të vegjël.
- Unë nuk i dalloj ngjyrat. Njerëzit më thonë se jam i bardhë dhe unë u besoj, sepse policët më thërrasin "zotëri".
- Gjithkush do të kishte besim tek vetja me një kokë plot me flokë. Por një qeros plot besim - ky është diamanti i dorës së parë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

17	1	8	4	2	4	13	1	13	1			
18	3	1	4		18	3		17	13	1		
8	1	10		10	10	1	3	1	6	12	6	
3		1	10	2	3	6	14	1	12	2	4	
13	3	5	4	2	8	4	1	12	4	2	4	
15	9	6	15	1	12	4	6		6	3	3	
17	2	4	5	12		2	14		17	5	1	4
8	1	7	6			3	1	10	1		2	
15	5	12		4	6	4	18	7	7	1	3	
1	3	2	8		1	5			2	12	2	
20	19		1	3		20	5	4	6	10	2	4
6	1		10	2	3	2	12	15	18	2	8	

M	I	K	E	K	M	S	E				
E	K	A		R	O	M	A	K	E	T	
K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T	
M	A	T	E	M	A	T	I	K	A		
P	A	S	A	N	I	K	T		S		
E	K	U		A	N	E	T	A	R	E	T
R	E	T	E		I	R	A	N	I		
I	T	R		B	L	A	K	E		L	
M	I	A		R	E	D		E	K	I	
E		M	E	T	A	L	E		I	S	
T	E	K	E		M	K	U	M	T		
M	O	R	A	V	I	A		M	A	E	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

A	R	K	A		A	S	T	R	O		A	M	A
D	I	A	N	A	H		A	N	T	I	K		
A	T	L	A	N	T	I	K	E	O	L	S		
P	E	I	T	A	R	I	F	A	T	L	E		
T	T	P	O	L	I	T	I	K	A	N	E	T	
		K	E	N	E	T	A	O	R	A			
P	A	U	L	I	N		R	R	I				
A	K	E	O	T	A	A	D		D	I	M		
R	O	M	U	N	E	K	N	I	A	M	E	R	A
E	T	J	I	T	E	R	T	I	A	M	A	N	E
E	E	I	G	O	R	D	I	A	N	E			
L	N	T	A	R	O	M	A	T	E	I			
P	A	B	M	E	L		E	R	G	O			
R	K	U	P	A	E	M	I	R	A	T	E		
O	H	A	R	A	D	A	R	O	M	A	T	E	
		C	I	K	L	I	S	T	E	T			
S	T	A	D	I	U	M	E	T	A	P	E	L	
D	I	K	A	S	T	E	R	E	J	R	U	E	
		K	E	N	T	I	N	G	O	P	J	E	U
K	A	T	I	A	S	I	E	L	E	S			
A	R	N	I	O	L	A	I	R					
A	M	A	S	S	I	M	O	Z	A	N	O	R	E
A	M	A	N	A	N	A	N	N					
T	T	E	R	R	E	N	I	E	I	N	E		

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- -Nëse një grua ju thotë se është njëzet dhe duket
- gjashtëmbëdhjetë vjeç, është dymbëdhjetë. Nëse ju thotë
- se është njëzet e gjashtë dhe duket si njëzet e gjashtë,
- është afër të dyzetave.
- -E gjithë bota çmendet kur reperi më i mirë është i bardhë,
- lojtari më i mirë i golfit është i zi, më i gjati
- në "NBA" është kinez, zviceranët fitojnë
- Kupën e Botës. Franca akuzon SHBA-në
- për arrogancë dhe Gjermania s'do të
- shkojë në luftë.
- -Nëse do të kuptosh të metat e një vajze,
- lavdëroje tek shoqet.

